

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7342 E premtë 3 Nëntor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës
Ditët e fundit ish-kryeministri i shkarkuar i rajonit autonom të Katalonjës, Carles Puigdemont ka ardhur këtu në Bruksel, jo për azil politik, ...
Vijon në faqen 18

Nga JORGJI KOTE
Marks, Hygo, Puigdemont... mërgimtarë në Bruksel


Dje në "Deutsche Welle"
530 gazetarë të vrarë. Vetëm midis viteve 2012 dhe 2016. Këtë shifër e publikoi UNSECO në një raport paraprak për "Report World Trend in Freedom ..
Vijon në faqen 19

Nga JULIA VERGIN
Jeta e rrezikshme e gazetarit



Debatet në Kuvend, ja çfarë u tha...

Himara debat në Kuvend, Basha i nxjerr videon, Rama: Kërceni palikarin

OSBE thirrje partive: Të nisë menjëherë reforma zgjedhore. Nuk duhet të ketë vonesa

Nga VALENTINA MADANI

Parlamenti për afro 4 orë u përfshi dje nga debate të forta mes mazhorancës dhe opozitës për çështjen e Himarës dhe situatën e krimit në vend. Debatit nisi mes kryeministrit Edi Rama dhe ...

Në faqet 2-3

ZBARDHET VENDIMI I KESHILLIT TE MINISTRAVE, NDRYSHOJNE AFATET PER CERTIFIKATEN

TOKE ME LIGJIN 7501, PROCEDURA PER TAPITË

"Regjistrim vendimeve që janë marrë nga gjykatat. Tokat e lira i kalojnë Agjencisë së Trajtimit të Pronave. Vlefshmëria e tokave bujqësore..."



(Në foto) Toka bujqësore

Në faqen 6

DETAJET PAS TERRORIT



Lotaria Amerikane, Kongresi nis shqyrtimin për mbylljen e programit

Në faqen 11

Qeveria miraton pagesat për familjarët nëse ka aksident e humbje të jetës në punë

"Ushtarakët e SHISH, përfitojnë mbrojtje"

Kriteret për përfitimin e ndihmës financiare për 2 institucionet

Nga ORNELA MANJANI

Qeveria përcakton kriteret dhe masën e përfitimit të ndihmës financiare për punonjësit e AISM (Punonjësit Civilë të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes). Garancia i vjen nga vendimi i Këshillit të

Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare në rast vdekjeje, sëmundjeje ose fatkeqësie për këta punonjës. Ky vendim vjen pas propozimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe si një detyrim për..."

Në faqen 7

SiCRED
me katër paketa sigurimi për Nxënësit dhe Studentët!
Lexoni në faqen 12

DETAJET E REJA

Gjykata e Katantias lë në burg Habilajn e 5 bashkëpunëtorët: Trafikuan drogë

Në faqen 8

DHUNE NDAJ MEDIAS

Presidenti: Respekt ndaj gazetarëve, askush të mos i intimidojë në punë!

Në faqen 5

EMERIMI PARA 2 MUAJSH

Drejtesia shkarkon kreun e Hipotekave, Doracaj: Jam në punë, s'kam njoftim

Në faqen 4

DOKUMENTET

Ish-të përndjekurit, lista e përfituesve të dëmshpërblimit nga kësti i I e II

Në faqet 14-15

REFORMA ZGJEDHORE TRYEZA

"Votimi dhe numërimi elektronik? Teknologjia të mos bazohet tek interneti"

OSBE, thirrje partive: Të nisë menjëherë reforma zgjedhore

Rekomandimet, Bochardt: Nuk duhet të ketë vonesa

Valentina Madani

Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, ambasadori Bernd Borchardt, bëri thirrje dje për një fillim sa më shpejtë të punës për reformën zgjedhore. Ambasadori tha se pret me padurim të nisë puna për një reformë të plotë e gjithëpërfshirëse, pasi sipas tij, nevojitet medoemos. Në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë, zyrtari i lartë deklaroi se kjo reformë duhet të nisë pa vonesa për të trajtuar të gjitha rekomandimet e OSBE/ODIHR për zgjedhjet e fundit dhe ato të mëparshme. "Dëshiroj të përshëndes krijimin e hershëm të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore dhe pres me padurim ta shoh atë të nisë punën sa më shpejt. Nevojitet medoemos një reformë zgjedhore e plotë, gjithëpërfshirëse dhe nënvizoj, pa vonesa, që do të trajtoj të gjitha rekomandimet e OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet e fundit dhe ato të mëparshme", tha ambasadori Borchardt. Lidhur me votimin dhe numërimin elektronik, ambasadori i OSBE këshilloi që teknologjia të mos bazohet tek interneti. "Autoritetet shqiptare duhet të shqyrtojnë me kujdes të gjitha mundësitë e politikave për identifikimin elektronik të zgjedhësve, votimin dhe numërimin elektronik. Praktikata e mira ndërkombëtare tregojnë se teknologjitë që nuk bazohen në internet janë më të parapëlqyera dhe më të realizueshme. Hakerat e kanë më të vështirë të sulmojnë këto lloj teknologjish. Futja e teknologjive të reja elektronike të votimit kërkon kohë. Nevojitet patjetër organizimi i një projekti pilot, mbasë një numër të caktuar bashkish në zgjedhjet e ardhshme vendore. Praktikata më të mira



PETRIT VASILI

"Përse na duhet ky kryeministër që i ka dalë dore korrupsioni? Indeksi i BB konfirmon që Shqipëria është në listën e vendeve që nuk kontrollojnë dot korrupsionin. Po ky kryeministër u griu miliona euro shqiptarëve për portale denoncuese e për konferenca, me dekore e me ekrane ku mbante llogore kilometrike për korrupsionin. E çfarë i kontrolloi korrupsionit? Asgjë, përkundrazi e thelloji".

tregojnë se edhe futja e teknologjive të reja të votimit kërkon kohë për zhvillimin e

studimeve të fizibilitetit, për planifikimin, edukimin e zgjedhësve dhe ndërtime e

besimit të publikut", deklaroi z. Borchardt. "Për këtë qëllim - tha ai - OSBE do të organizojë një konferencë të nivelit të lartë mbi teknologjitë e reja të votimit më 13 dhjetor në Tiranë. Konferenca do të ofrojë hollësi rreth praktikave të mira ndërkombëtare. Rekomandimet dhe përfundimet do t'i propozohen Kuvendit të Shqipërisë". Kurse për kreun e KQZ-së, Klement Zguri, reforma e ardhshme zgjedhore përbën një kusht, një mundësi e një detyrim për zhvillime cilësore, përbën premisën e të gjitha objektivave madhore që Shqipëria ka përpara. "Prandaj kjo reformë duhet të bëhet nëna e të gjitha reformave, duhet të jetë e plotë dhe gjithëpërfshirëse, duhet të jetë transparente, e vendosur, e sigurt dhe altruiste. Kjo



Seanca e djeshme plenare



Balla zbulon pse Berisha sulmon ish-kryeministrin rumun, Ponta

Kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla, në seancën e djeshme parlamentare ka replikuar me ish-kryeministrin Sali Berisha në lidhje akuzat e këtij të fundit ndaj ish-kryeministrin të Rumanisë, Viktor Ponta. Në fjalën e tij, Balla theksoi se për fat të keq, një ish-kryeministër apo një ish-ministër i Jashtëm përdorin emrat e autoriteteve të vendeve të tjera për hesape të baltes së tyre brenda Shqipërisë. "Sali, nuk të kam kthyer kurrë përgjigje për ish-kryeministrin rumun, Viktor Ponta, të cilin fati e ka bërë që të ishte Kryeministër i Rumanisë për një kohë të gjatë. Ishte i vetmi Kryeministër i Rumanisë që vendosi të njëjtte Kosovën. Ka ardhur edhe në Tiranë, ka bërë të njëjten gjë dhe në Bukuresht, ka bërë të njëjten gjë me Presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, e ka bërë me të gjitha autoritetet kosovare", theksoi Balla. Gjithashtu, ai i bëri thirrje Berishës të heqë dorë nga sulmet e ulëta personale përkundër të gjithë atyre që bëjnë një gjë të mirë për Shqipërinë dhe Kosovën.

Kryemadhi: Bashkojmë votat me qeverinë vetëm për minatorët



janë fituar rreth 40 milionë euro dhe faktura e statusit të minatorit që kemi paraqitur ne në Parlament nuk është më shumë se 10 milionë euro në vit. Pra, nuk është as 25 përqind të atij fitimi të pastër, që merr vetëm nga renta minerare që paguan miniera. Nuk po llogarisim këtu dividendin, tatimin që vendoset, transportet apo naftën që shpenzohet dhe shumë e shumë gjëra të

tjera. Nuk po llogaris as kontributin e pafund 70-vjeçar të kësaj miniere apo edhe i shumë minierave të tjera", deklaroi z. Kryemadhi. Ajo përmendi se: "Në fakt ia kemi dhënë disa herë shansin kryeministrit për të qeverisur dhe nuk ua kemi dhënë shansin që meritojnë asnjëherë minatorëve. Ndaj është momenti që me këtë status t'ua japim shansin minatorëve, sepse e meri-

PROTESTAT E PD

Deputeti i PD, Tritan Shehu paralajmëroi dje se opozita po përgatitet për protesta kundër qeverisë "Rama". "Marrëveshja është e mbyllur, ishte e vlefshme për kohën që u bë. Reforma zgjedhore është detyrim nga OSBE. Zgjedhjet politike mund të vijin edhe para zgjedhjeve lokale, këtë e ka në dorë sovranin. Sovrani shpeshherë të detyron në mënyra demokratike. Duke shfrytëzuar rrugët, sheshet dhe të gjitha mënyrat demokratike. PD është duke punuar fort", deklaroi z. Shehu.

tojnë dhe ne si klasë politike ndihemi mjaft borxhlinj ndaj jush".

REDAKSIONI: Redaktor i Suplementeve dhe Socialës: Rezarta Delsula, Redaktor i Rrethëve: Trëndafille VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.

ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Lllaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autokorëvës, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116, Marketingu: Tel:(04) 2359-104/039-123, Tiranë, Internet: www.gsh.al, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPURINË "Klasik" Shpk

Valentina Madani

Parlamenti për afro 4 orë u përfshi dhe nga debate të forta mes mazhorancës dhe opozitës për çështjen e Himarës dhe situatën e krimit në vend. Debatimi nisi mes kryeministrit Edi Rama dhe kryetarit të PD-së, Lulzim Basha. Më pas, pjesë tjetër u bë dhe ish-kryeministri Sali Berisha dhe kreu i PBDNJ-së, Vangjel Dule. Kryeministri Rama riktheu në vëmendjen të marrëveshja për detin, duke e akuzuar PD-në se shiti hapësirën detare. Z.Rama akuzoi PD-në se për hir të pushtetit janë gati ta bëjnë mejdan të luftës politike edhe një çështje që është kombëtare, si ajo e Himarës. "Çfarë është Himara për ju?" ishte pyetja e Ramës për PD-në. Në replikë, Berisha theksoi se në Himarë po ndodh "një agresion mafioz i turpshëm". Z.Berisha bëri opozitë për Himarën. Akuzoi Ramën se prishi masterplanin britanik për një studim të ri se ku do të ndërtojë Olsi Rama dhe miqtë e tij. Ish-kryeministri publikoi një fjalim në greqisht të kryeministrit Rama dhe e mbylli replikën duke bërë thirrje për revolucion popullor. Ndërsa Basha vijoi opozitën, duke e akuzuar se e ka kthyer Shqipërinë në një njollë droge dhe Rama e Habilajti janë kryepërfituesit me 1.3 miliardë euro. "Pse e mbushë këtë parlament me të dënuar nga e gjithë Europa për trafikun e drogës, pse i bërë kryetarë bashkish, ç'punë ka kryebashkiaku yt në komisaratin e policisë kur arrestohet Durim Keçi? Nuk ka asnjë arsye tjetër për moshapien e negociatave, përveç faktit se vendi sundohet nga krimi, që qeveria jote është e zhytur në krim dhe është e kapur nga krimi", theksoi z.Basha. Kurse kryeministri Rama akuzoi Dulen se minoritetin e ka kthyer në biznes politik dhe kreu i PBDNJ-së kishte një



KRAHASIMI

Gjatë debateve në Kuvend, ish-kryeministri Berisha e krahasoi kreun aktual të qeverisë, Edi Ramën, me një "strukturë fallike". "Je një strukturë fallike, nxirren jashtë këtë strukturë fallike", i drejtohet Berisha kryeministrit.

REAGIMI

Z.Berisha publikoi një audio të z.Rama, i cili flet në greqisht. Z.Rama u përgjigj Berishës se nuk di greqisht, por ka përshëndetur kongresin e PASOK-ut. "Gjuhët unë nuk i kam ndërtim pa leje, por greqisht nuk di. Kam përshëndetur kongresin e PASOK-ut, meqenëse nuk shkoja dot atje".

Debatet në Kuvend, nga Himara, droga, kastravecit e qirjo deri te klouni

Berisha i nxjerr videon, Rama: Kërçeni palikarim

Basha: Je si taleban, kryepërfitues i drogës

përgjigje për këtë. "Unë e paskam kthyer në biznes mbrojtjen e të drejtave të minoritetit?! Siç mendon e vepron mbrapsht vetë, kujtonse mendojnë dhe vepronjë mbrapsht të gjithë. Pse nuk përgjigjesh për kanabizimin vendit?", tha z.Dule.

PAKTI

Ish-kryeministri Sali Berisha akuzoi nga foltorja e Kuvendit lidhur me rrezimin e Marrëveshjes së Detit me Greqinë nga Gjykata Kushtetuese. Berisha tha se janë përdorur para e korrupsion, duke iu referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila rrezoi marrëveshjes mes dy vendeve në vitin 2009, e cila sipas vendimit të Kushtetueses cenonte integritetin territorial të Shqipërisë. "Përmende Marrëveshjen e Detit. Do të të them kaq: Bëre gjithçka me para dhe korrupsion, anulove një marrëveshje, e cila në njëmijë gjykata po të dalë në parim in të traktatit të deteve është...", tha Berisha. Kreu i qeverisë u përgjigj se Berisha po mbron marrëveshjen që i hiqte Shqipërisë një pjesë të territorit me firmë të ish-ministrit të Jashtëm, Lulzim Bashës, ndërsa i cilësoi absurde akuzat për korrupsion dhe blerjen e gjyqtarëve të Kushtetueses në rrezimin e kësaj marrëveshjeje. Sipas Ramës, Berisha i qëndron ende asaj marrëveshjeje dhe gjithçka



Kryeministri Edi Rama dhe ish-kryeministri Sali Berisha

është hartuar dhe punuar me bekimin e tij e fitimorun nga Basha, në atë kohë ministër i Jashtëm. "The këtu që Marrëveshjen e Detit e paskam rrezuar unë në Gjykatën Kushtetuese, e cila votoi 9 me 0, kurrrë nuk ka ndodhur më parë, me para dhe korrupsion, the këtu ti. E di që e the, akuzë shumë e rëndë për atë gjykatë, që me atë vendim ka marrë në mbrojtje interesin kombëtar dhe nuk ka marrë para dhe nuk ka bërë korrupsion. Ndërkohë, edhe një autodeklarim i ty, që i atë marrëveshjeje e ke dashur e ke bërë nëpërmjet dorës tënde në Ministrinë e Jashtëm, që sot e ke kryetar partie të komanduar dhe që ti i qëndron asaj marrëveshjeje. Rëndësi ka që shqiptarët ta dëgjojnë këtë. Dhe vazhdo duke bërë të njëjtën gjë që bëri PD dhe

në Himarë, duke ushqyer ato zëra dhe ato forca në anën tjetër të kufirit, që propagandojnë këtë teori të ulët, të shpifit dhe të pavërtetë", deklaroi Rama. REAGIMI Në replikat me kreun e PBDNJ-së, Vangjel Dulen në parlament, njëherësh dhe ish-kryeministrit Sali Berisha, kryeministri Rama Edi Rama përmendi jo pa ironi fjalët greqisht "qirje" që përkthehet "zotëri" dhe "palikari", që përkthehet "djalë trim". Ndërsa me "qirje" iu drejtua ish-kryeministrit Berisha, fjalën "palikari" e përdori teksa replikonte me Dulen për projektin e urbanizimit, që shkaktoi protesta në Himarë. "Kenë bërë një hesap pa hanxhinë z. Vangjeli. Hanxhiu është atje. Ishite në 25 qershor dhe këtu

PËRGJIGJJA

"Ky është kloun që nuk i përgjigjet pyetjes pse e zhyti Shqipërinë në drogë. Je bërë karikatürë. Strehë e fundit e maskarait është pseudopatriotizmit. Ja ku e ke eksportin tënd, o më i madhi i kastravecëve. Droga është eksporti yt", tha z.Basha.

do jemi. Ua kam thënë në 2013-ën, ua kam thënë në 2015-ën, ua kam thënë në 2017-ën, po ua them sot në 2019-ën. Ju vazhdoni bjerini gjajdes, ja ku e keni gramafonin. Ai përpara, ju mbapa, kërceni atë palikarin, si quhet ajo dhe do e shikoni". Lulzim Basha tha se këshu siç e ka nisur, Rama mund të heqë edhe corapat në parlament. Por më i fortë ishte reagiimi i deputetit demokrat, Ervin Salianji, sipas të cilit, Ramës duhet t'i ndërprejt fjalë, pasi në këtë orë televizionin e ndjekin edhe fëmijët. "Kryeministri mbajti këtu 7 minuta palikarin në gojë, këtu është Kuvendi i Shqipërisë dhe duhet të flisni në shqip. Nuk mund të shkëlni këshu rregullon, jemi Kuvend të punimet mund t'i ndjekin fëmijë të të gjitha moshave", u shpreh Salianji.

NGA HIMARA TE DROGA, DEBATET E FORTA NE KUVEND MES KRYEMINISTRIT RAMA DHE PERFAQESUESVE TE OPOZITES

- Edi Rama, Bashës: Hajde këtu tani, jepu përgjigje shqiptarëve si ka mundësi që PD u shfaq që në Himarë? Lulzim, ndryshimi mes meje e tje për gjuhën është se unë kam Fan Nolin e Konicin mësuës, ti ke mësuës Salin e Monikën.
Lulzim Basha: Pse e mbushë këtë parlament me të dënuar nga gjithë Europa për trafikun e drogës, pse i bërë kryetarë bashkish, ç'punë ka kryebashkiaku yt në komisaratin e policisë kur arrestohet Durim Keçi? Nuk ka asnjë arsye tjetër për moshapien e negociatave, përveç faktit se vendi sundohet nga krimi, që qeveria jote është e zhytur në krim dhe është e kapur nga krimi.
Sali Berisha: Në vend që të qërohët "Haki droga", largohet nga detyra shefi i SHISH. Për arsye se i raportoi me dhjetëra e qindra herë kreu të shtetit, por edhe vetë "Noriges" për narkoshitin e zivillimin e tij. Kjo lëvizje inekstrimis përbën rrvanishin më të fuqishëm të narkoshitit dhe krimt të organizuar. Ka vetëm një rrugë për të shpëtuar nga kjo situatë, një revolucion popullor, që do të çlirojë Shqipërinë nga "Norige" e kthetare e tij. Ajo që shihni në Himarë është një agresion mafioz i turpshëm ndaj qytetarëve krenarë, që kanë qenë e mbeten bastion i shqiptarizimit. Ka asnjë studim të një prej kompanive më serioze në botë në Britani, masterplan, i cili përcakton se ku nuk mund të ndërtohet. Ky studim përbëmbi një studim të mëparshëm po të partisë tju, e cila përcakton se ku klientela do të ndërtohet. Ky zotëria përbëmbi studimin britanik. Pse nuk pati sherr 8-vjeçar? Sepse ky përbëmbi studimin britanik dhe në studimin tjetër sipas të cilit, këtu do të ndërtojë Osi e atje tjetri dhe u vëndi hurm qytetarëve të Himarës.
Vangjel Dule: Abuzon me këtë mikrofon, me gjëra urretjelle, me gjuhë raciste, me gjuhë steroitipale dhe dallimshme dhe me gjuhë diskriminimsh. Juve kam për detyrë ta ndërprisni, sepse shndërrohet kjo foltorja në një foltore turp, ngaqë ai nuk ka turp.
Edi Rama: Si minoritar, të takonte ty të dije këtu dhe ta pyesje qirjo Salin ç'kishte me atë të folurën greqisht. Nuk di ti i dëgjoje fjalët raciste dhe e pe gjuhën e urrojtjes. Foto për një çështje, që është çështje e këtyrë vendi dhe popullit. As nuk shava kënd dhe as nuk lëshova gysmë fjalë me termat që sapo përmende. Mbasa si minoritar, të takonte dhe ta pyesje qirje Salin çfarë kishte me atë të folurën tim në greqisht. Ti tregoje qirje Salin se gjuha jote është e madhe dhe nuk ke të drejtë ta keqërdorje, siç e bëri qirje Salin. Ti minoritetin e ke biznes politik, unë nuk kam biznes politik. Tani qirje Salin folu nga havaja jote. Nuk ka lidhje fare masterplanin, por bëhet fjalë për një projekt urbanizim për shehin e Himarës, kopshtin, ndërtesën e re të Bashkisë së Himarës dhe përfundimin e projektit të Bashkisë së Himarës. I ngatërove dy gjëra. Unë nuk vij këtu (Sali) me librin tënd të shtëpisë. E detyra, qirje Salin, Shqipëria është nën akuzë nga fqinjët për shkak të të drejtave të minoritetit në Himarë. Ajo që të takonte ty dhe të takon është që kur të vije këtu, të mos flisje nga havaja, por si ish-kryeministri i Shqipërisë.

HIPOTEKAT NDRYSHIMET

Drejtoresha e Hipotekave shkarkohet dy muaj pas emërimit nga Rama

Ministria e Drejtësisë shpall vendin e lirë, Doracaj: Jam në punë, s'ka shkarkim

Drejtori i shkarkuar i ankohet kryeministrin



Kryeministri në takimin e parë me kryeregjistruesen

Deputeti i PS akuzua të forta ndaj Ministrisë

Braçe: Ulëritës abuzimi në treg Peleshi: Shkrimë Drejtoritë e Bujqësisë

Ministri i Bujqësisë, Niko Peleshi njoftoi dje, në Kuvendin gjatë interpelancës së kërkuar nga deputeti i PS-së, Erjon Braçe se, Drejtoritë e Bujqësisë në vend do të shkrihen dhe do të riorganizohen, pasi deri më tani nuk e kanë bërë, siç duhet punën e tyre. Ai tha se gjatë vitit 2018 do të zbatohen reforma në fushën e bujqësisë për të sjellë një realitet të ri të prekshëm nga fermeri. "Drejtoritë e Bujqësisë në vend do të shkrihen dhe do të riorganizohen, pasi deri më tani nuk e kanë bërë siç duhet punën e tyre. Ky do të jetë një shërbim, që në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të

Darina Tanushi

Ministria e Drejtësisë publikoi dje, shpalljen e vendit vakant për kryeregjistrues të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Në këtë pozicion aktualisht vazhdon të jetë e emëruar nga kryeministri Edi Rama, Blerina Doracaj. Ajo u emërua dy muaj më parë nga kreu i qeverisë, pas thirrjes që u bëri drejtorëve të LSI-së që të lëshojnë postet drejtuese në administratë. E kontaktuar nga "Gazeta Shqiptare", Blerina Doracaj deklaroi se ishte në zyrë dhe nuk kishte asnjë dëgjim për shkarkim të saj. "Lajmin po e lexoj në media. Jam në zyrë. Kam kontaktuar me instancat e varësisë dhe më është komunikuar që nuk ka asgjë të vërtetë. Nuk ka as pezullim dhe as shkarkim nga detyra. Puna vijon rregullisht. Siç është hapur konkurs për kryeregjistrues në të gjitha rrethet e vendit, edhe pozicioni i kryeregjistruesit të ZQRPP do të nënshtruhet procesit të konkursit", tha Doracaj. Në kriteret e publikuara nga Ministria e Drejtësisë kërkohet që kandidatët për pozicionin e kryeregjistruesit në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të plotësojnë kriteret e përgjithshme, si vijon: të jetë shtetas shqiptar; të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, ekonomik, inxhinierik ose menaxhim publik; të ketë përvojë pune jo më pak se 7 vjet në administratën publike; të mos ketë qenë i dënuar penalisht; të mos ketë konflikt interesi. Aplikimet janë të hapura deri më datën 16 nëntor. Ndërkohë që, sipas deklaratës, vetë drejtoresha aktuale e hipotekave nuk është lajmëruar. Ajo ka shkruar në punë normalisht këto ditë. Por, sipas dokumentit të publikuar nga newsbomb.al, një prej punonjëseve të zyrës, Drini Mataj i ka dërguar një letër kryeministrin Edi Rama ku ankohet për mënyrën si ka vepruar në këto dy muaj Doracaj.



Blerina Doracaj

AKUZAT

Drini Mataj, Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse në Zyrën Qendrore të ZQRPP, akuzon Doracajn për shkelje të rënda të detyrës, nga emërimet nepotike të ndërhyrjet në protokoll dhe dokumente zyrtare, deri të favorizimi i njerëzve të saj të afërt. Mataj i ka shkruar kryeministrin se Kryeregjistruesja, Znj Doracaj i kishte propozuar të punonte me të, por në datën 20 tetor, në orën 6 pasdite, në emailin personal me një komunikim me email nga kryeregjistruesja i ka ardhur urdhri i shkarkimit pa asnjë motivacion. "Ditën e premte, 3 ditë pas urdhrit të shkarkimit, më ka deleguar detyra me shkrim. Ky është një shpërdorim i hapur i detyrës pasi

ka ndërhyrje në protokollin e një prej tre institucioneve më të rëndësishme në Shqipëri. Këtë e provoj me shkresa zyrtare", shprehet Mataj. Sipas tij, Doracaj ka emëruar kushërinj të parë të saj dhe të bashkëshortit në Hipotekë. Ai shprehet se ka emëruar një sekretare me nivel aspak etik dhe profesional si dhe pa arsimin përkatës në komisionin më të rëndësishëm të ministres së Drejtësisë për përzgjedhjen e drejtuesve të Hipotekave të rretheve. Mataj e akuzon Doracajn se ka kryer edhe shkarkime të tjera pa motivacion. Sipas Matajt praktikant e qytetarëve në Hipotekë nuk bëhen sipas radhës kronologjike dhe sipas ligjit. Mataj shprehet se Doracaj

CV

Blerina Doracaj ishte pjesë e listës së kandidatëve të PS së Tiranës dhe u rendit në vendin e 23-të në listë. Doracaj është prej vitësh anëtare e PS-së, e aktivizuar me Forumin Rinor Eurosocialist që në moshën 17-vjeçare. Aktualisht është kryetare e Forumit të Gruas në Partinë Socialiste.

është e paqëndrueshme në vendime, i merr dhe i ndryshon ato. Burimet bëjnë me dije se Doracaj është e gatshme të përballlet me akuzat e Matajt. Kujtojmë se 35-vjeçarja Blerina Doracaj ishte pjesë e listës së kandidatëve të PS së Tiranës dhe u rendit në vendin e 23-të në listë. Doracaj është prej vitësh anëtare e PS-së, e aktivizuar me Forumin Rinor Eurosocialist që në moshën 17-vjeçare. Aktualisht është kryetare e Forumit të Gruas në Partinë Socialiste. Më parë ajo ka punuar si këshilltare e Milena Haritos në Ministrinë e Inovacionit dhe Administratës Civile, ndërsa është zgjedhur edhe këshilltare e PS në Këshillin Bashkiak të Tiranës.

Zv. kryeministria takon homologët malazez dhe serb

Senida Mesi: Integrimi në BE, mision i përbashkët i Ballkanit Perëndimor

Zv/kryeministria e Shqipërisë, Senida Mesi mori pjesë dje, në Konferencën Ekonomike të Ballkanit Perëndimor "Sfidat në rrugën drejt Bashkimit Evropian", organizuar në Budva të Malit të Zi nga Dhoma e Ekonomisë së këtij vendi dhe qeveria malazeze. Në panelin e diskutimit të kësaj konference ku ishin, gjithashtu, të pranishëm përfaqësues të lartë nga vendet e rajonit, gjatë fjalës së saj, zv/kryeministria Mesi nënvizoi rëndësinë e rritjes së bashkëpunimit dhe sinergjisë, pavarësisht sfida të ndryshme që mund të ketë secili shtet i Ballkanit Perëndimor. Duke shprehur bindjen se bashkërendimi i strategjive

të vendeve të rajonit ngelet një domosdoshmëri për sinkronizimin e nevojave të qytetarëve dhe sipërmarrjes, znj. Mesi u ndal tek integrimi drejt Bashkimit Evropian si një mision i përbashkët i shteteve të Ballkanit Perëndimor. Brenda këtij kuadri, ajo tregoi progresin e çmueshëm që Shqipëria ka bërë dhe nënvizoi faktin se qeveria shqiptare mbetet tërësisht e angazhuar në plotësimin e çdo prioriteti për arritjen e këtij synimi madhor. Gjatë ditës së Konferencës Ekonomike, zv/kryeministria Mesi zhvilloi, gjithashtu, takime dypalëshe me kryeministrin e Malit të Zi Duško Marković dhe zv/kryeministrin e Serbisë Rasim Ljajic.



Tiranës do të realizohet pas hartimit të moduleve të trajnimit për ekspertët e fushës. Do të bëhet me qëllim organizimin e këtyre shërbimeve", deklaroi Peleshi. Gjatë kësaj interpelance janë dëgjuar edhe tonet e ashpra, pasi deputeti Braçe hodhi akuzat të forta ndaj kësaj ministrie, duke i kërkuar që të rregullojë çmimin mes fermerëve dhe tregtarëve, sepse sipas tij, çmimi nga fusha në treg trefshohet. Braçe tha se ka një abuzim ulëritës në treg, teksa shtoi se ekziston një rrjet tregtarësh që janë të aftë të kryejnë këtë abuzim. Nga ana e tij, ministri Peleshi tha se po punohet për të tejkaluar këto problematika, duke vënë theksin të informacioni. Sipas tij, duhet një bursë që çdo fermer të marrë vesh çmimet në çdo treg. Duke i dhënë të drejtë atyre çfarë tha deputeti Braçe, Peleshi u shpreh më tej: "Ne kemi dyfishuar sipërfaqen nën ujë, megjithatë kemi dhe disa mijë hektarë të tjera pa ujë. Brenda këtij viti do përfundojmë 29 skema, do shtojmë me 10 mijë hektarë nën ujë. Do vazhdojmë decentralizimin, pjesën më të madhe të infrastrukturës dytësore dhe trefësore ua kemi dhënë bashkëve. Po përmbyllim negociatat me BB për 25 milionë euro të tjera për skemën e ujitjes për vitin 2018".

Shoqëria përbarimore "AFA-2010" sh.p.k
shpall Ankandin për shitjen e pasurisë së paluajtshme:

Pasurisë me Nr.3369 e llojit "Trulli + Banesë 3 katëshe" me sip. trulli 350 m²; dhe sip. banesë 191.9 m². (kati përderë 191.9 m², kati i 2-të 0.03 dhe kati i 3-të 0 m²) ndodhur në L. "11 Janar", ZK. 2310. Kuqovë në pronësi Agim Isa Zeqja. Çmimi fillestar në ankandin e dytë është është 11,200,000 Lekë. Ankandi zhvillohet në datë 09.11.2017, ditën e Enjte ora 15.30 n në ambientet e Shoqërisë Përbarimore "AFA-2010" sh.p.k në adresën "Rruga "Sulejman Delvina", Nd.51, H.9, Ap.1, Tiranë.
Për info. Tel:044503458 ose Email shoqeriaferbarimoreafa2010@gmail.com



Presidenti, pritje në "Ditën e pandëshkueshmërisë së dhunës ndaj gazetarëve"

Meta: Të respektohet integriteti i gazetarëve, askush të mos i intimidojë

"Institucionet të veprojnë për aktet e dhunës ndaj medias"

Darina Tanushi

Presidenti i Republikës, Ilir Meta dha dje një pritje për gazetarët, në kuadër të "Ditës Ndërkomëtare për t'i dhënë fund pandëshkueshmërisë së dhunës ndaj gazetarëve". Presidenti Meta fillimisht shprehu solidaritetin me gazetarët e pranishëm dhe me kolegët e tyre kudo ku janë, duke vënë në dukje rëndësinë e misionit të tyre jetik dhe vendimtar në paqyrimin e saktë e të paanshëm të lajmeve dhe ngjarjeve më aktuale të realitetit të përditshëm shqiptar.

"Dëshiroj të shpreh respektin dhe mirënjohjen për misionin tuaj si misionarë të fjalës së lirë dhe të vetë lirisë mbi të cilën është ndër-tuar e gjithë shoqëria jonë demokratike dhe pa garantimin e së cilës ajo nuk mund të funksionojë më mirë dhe sipas standardeve evropiane. Me këtë rast dua të shpreh solidaritetin më të fortë dhe më të singërtë me të gjithë gazetarët në vendin tonë, në shërbim të misionit të tyre, që ka një rëndësi vendimtare dhe kyçe edhe për



Presidenti i Republikës, Ilir Meta

të ardhmen e mëtejshme të vendit. Ashtu sikurse ka qenë vendimtar dhe jetik i gjithë ai progres që vendi ka realizuar në këto 27 vite", - vuri në dukje Presidenti i Republikës. Duke shprehur ndjeshmërinë më të madhe për integritetin dhe profesionalizmin e gazetarëve, Presidenti Meta theksoi se duhet: "Të respektojmë integritetin profesional të gazetarëve. Askush të mos intimidojë për asnjë arsye këtë integritet profesional dhe akoma më rëndë person-

al, për shkak të profesionit tuaj dhe shërbimit tuaj ndaj të vërtetës dhe ndaj ngjarjeve, fakteve, pasi kur deformohet dhe cenohet liria dhe të drejtat e gazetarëve, pa dyshim që është cenuar vetë themeli i sistemit tonë demokratik dhe kjo është një ndjeshmëri, që jam i bindur se e ka e gjithë shoqëria jonë në tërësinë e saj". Presidenti i Republikës u bëri thirrje gjithashtu të gjitha institucioneve shtetërore që "të veprojnë në mënyrë të menjëhershme dhe shembullore

sa herë që ka akte dhune apo përpjekje për akte të tilla ndaj gazetarëve dhe përfaqësuesve të medias, për shkak të përmshjes së detyrës suaj dhe të realizimit të misionit tuaj". Presidenti Meta ripërsëriti duke nënvizuar dhe njëherë solidaritetin e tij personal dhe institucional ndaj gazetarëve të terrenit në shërbim të lirisë së shtypit. "Gjithmonë do të jem këtu gjatë këtyre pesë viteve në mbështetjeje e misionit tuaj, të të gjithë gazetarëve. Një solidaritet të

Kur deformohet dhe cenohet liria dhe të drejtat e gazetarëve, pa dyshim që është cenuar vetë themeli i sistemit tonë demokratik dhe kjo është një ndjeshmëri

veçantë do të doja të shprehja sidomos për gazetarët e terrenit, për ata që raportojnë ngjarjet, faktet në mënyrë të menjëhershme, shpesh edhe duke sakrifikuar në çdo kohë, shpesh edhe duke rrezikuar për shkak të ngjarjeve dhe karakterit të ndryshëm të tyre, gjithmonë në shërbim të lirisë, në shërbim të qytetarëve dhe në interes të konsolidimit të të gjithë sistemit tonë demokratik", - nënvizoi në përfundim të fjalës së tij Presidenti Meta.

DEKLARATA

"Të respektojmë integritetin profesional të gazetarëve! Askush të mos intimidojë për asnjë arsye këtë integritet profesional dhe akoma më rëndë personal, për shkak të profesionit tuaj dhe shërbimit tuaj ndaj të vërtetës dhe ndaj ngjarjeve, fakteve, pasi kur deformohet dhe cenohet liria dhe të drejtat e gazetarëve, pa dyshim që është cenuar vetë themeli i sistemit tonë demokratik", - tha Meta.



Dosja "Habilaj", Marco Minniti do të takohet me Metën e Xhafajn

Ministri i Brendshëm italian, sot në Tiranë për luftën antikanabis

Ministri i Brendshëm italian, Marco Minniti nis sot një vizitë zyrtare në Shqipëri. Në vizitën e tij në vendin tonë, ministri i Brendshëm i Italisë do të shoqërohet nga një delegacion i nivelit të lartë i ministrisë dhe policisë italiane. Takimin e parë Minniti do ta ketë me homologun e tij shqiptar, Fatmir Xhafajn, për të vijuar më pas me një takim me kreun e shtetit, Ilir Meta në Presidencë. Në kuadër të kësaj vizite, në Pallatin e Kongreseve do të zhvillohet "Konferenca e përbashkët mbi raportin përfundimtar të misionit të monitorimit ajror për vitin 2017, në luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike" ndërmjet Policisë së Shtetit, Policisë italiane dhe Misionit të BE-së. Në orën 10:00 vizita nis me takimin e ministrave Xhafaj-Minniti, në Ministrinë e Brendshme. Më pas, në orën 11:00 ministri i Brendshëm italian do takojë Presidentin e Republikës, në Presidencë dhe në 11:30 do të mbahet konferenca përfundimtare e "Misionit të monitorimit ajror 2017 në luftën antikanabis". Kjo vizitë vjen në një moment, kur po diskutohet shumë edhe për dosjen "Habilaj", për të cilën ka një hetim edhe në Itali.



Avokati i njohur përfaqëson në gjyq gruan e Agim Arapit, të varur në Durrës

Spartak Ngjela, letër Metës dhe Lllallës: Po kërcënohemi nga vrasësit

Avokati Spartak Ngjela dha një letër për Presidentin Ilir Meta dhe kryeprokurorin Adriatik Lllalla kërkon ndërhyrje institucionale për një proces gjyqësor të deformuar në Gjykatën e Durrësit. Zyra e Avokatit të njohur përfaqëson në gjyq Vjollca Arapin, burri i së cilës u vra në prill të këtij viti nga tre persona për shkak të pagesës së një qiraje. Kujtim Ekonomi, Kostandin Ekonomi dhe Jergen Kurti rrahën për vdekje 58-vjeçarin Agim Arap. Ndërkohë që akuzat për vrasje është ndryshuar nga prokurori i çështjes gjatë procesit. Avokat Ngjela shprehet se prokurori i çështjes po ndihmon autorët e dyshuar të vrasjes. Për "Koha Jone" avokati i njohur denoncon publikisht dhe



Avokati, Spartak Ngjela

kërcënimet që ka marrë zyra e tij ligjore nga autorët e dyshuar. Ngjela thotë se detyrohet të publikojë dokumentin për kreun e shtetit dhe kryeprokurorin, për shkak

se, "ndaj zyrës sonë ka kërcënime dhe abuzime të mëtejshme në funksion të hetimit të kësaj çështjeje". Duke paraqitur faktet për presidentin, në cilësinë e

kryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe kryeprokurorin Adriatik Lllalla, Ngjela kërkon ndërhyrjen e menjëhershme institucionale për këtë proces. Ngjela thotë se kjo çështje faktin korupsionin në sistemin e drejtësisë. "Kam mendimin se, duke sqaruar opinion publik edhe për aspektet e reja që kanë lidhje me denoncimin e prokurorit dhe me kërkesën drejtuar kryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, sqarohet më tej kjo çështje, e cila për mendimin tonë, është një fragment real i korupsionit në sferën e drejtësisë, sidomos tani që ka filluar realisht procesi vetingut", - tha avokati Spartak Ngjela.

Regjistrim vendimeve të gjykatave. Tokat e lira i kalojnë Agjencisë së Trajtimit të Pronave

Zbardhet VKM-ja, tokë me 7501, ndryshojnë afatet për tapitë

Procedurat për marrjen e certifikatës

Ornela Manjani

Këshilli i Ministrave vendosi të shtyjë afatin për pajisjen me certifikatë pronësie të tokave që janë shpërndarë me ligjin 7501. Aktet e marrjes së tokës në përdorim për tokat bujqësore janë shpërndarë në zbatim të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", i cili është ndryshuar në mbledhjen e fundit të Këshillit të Ministrave. "Afati i plotësimit të AMTP-ve përfundon në datën 31 korrik 2018", - thuhet në VKM. Ndërkohë vetëm pak kohë më parë qeveria vendosi që të gjithë titujt e pronësisë që janë përfunduar në zbatim të ligjit për ndarjen e tokës bujqësore do të verifikohen jo vetëm për gjithshmërinë e lëshimit të tyre, por edhe me ballafaqimin e sipërfaqeve në terren me ato të regjistruara në dokumentet. Në ligjin 7501 përcaktohet që toka bujqësore të ndahet për frymë për banorët që janë regjistruar në fshat në momentin e ndarjes së tokës, në korrik të vitit 1991. Të dhënat e sakta do të hidhen në regjistrin e Zyrave të Regjistrimit të Pasurive. Në ZRRP do të regjistrohen edhe të gjitha vendimet e gjykatave që kanë marrë formë të prerë. Në përfundim të këtij procesi gjitha sipërfaqet që do të rezultojnë të lira do të kalojnë në fondin e Agjencisë së Trajtimit të Pronave. Vendimi është marrë dhe në Këshillin e Ministrave.

VENDIMI

Qeveria miratoi dhe disa ndryshime në vendimin nr.1269, datë 17.9.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar. Në vendim përcaktohet që të kryen vlerësimet ligjore të krijimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi, të plotësuar nga kryetarët e bashkive, për familjet bujqësore ose individët, në rastet e kërkesave të paraqitura nga qytetarët apo institucionet shtetërore, në territoret e: a) ish-kooperativave bujqësore, në zbatim të pikës 1/1, të nenit 17, të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën



FONDI PËR ATP

Në vendimin e qeverisë është përcaktuar që komisionet vendore kanë detyrimin që brenda dy muajve nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi të paraqesin në Agjencinë e Trajtimit të Pronës të gjitha vendimet gjyqësore përfundimtare, të marra para kësaj date, të shoqëruara me planvendosjet e ngastrës/ave dhe procesverbalin/et përkatës".

Si u dhanë titujt e pronësisë, procedurat dhe dokumentacioni

Dhënia e tokës bujqësore në pronësi realizohet dhe vërtetohet vetëm me dokumentin bazë unik, që është "akti i marrjes së tokës në pronësi". "Akti i marrjes së tokës në pronësi" është i vlefshëm vetëm kur ai është krijuar sipas procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 230, datë 22.7.1991, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e komisioneve të tokave", të ndryshuar dhe në udhëzimin nr.2, datë 2.8.1991, të Këshillit të Ministrave "Për funksionimin e komisioneve të tokës në rrethet e fshatra". Titujt e pronësisë për tokat bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore janë të vlefshëm vetëm kur janë krijuar sipas dispozitave të ligjit nr.8053, datë 21.12.1995 "Për kalimin në pronësi, pa shpërbllim, të tokës bujqësore" dhe procedurave të përcaktuara në udhëzimin nr.106, datë 23.2.1996, të ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit "Për procedurat e kalimit të tokës nga përdorimi në pronësi".



bujqësore", të ndryshuar; (Procedura e ndarjes së tokës bujqësore në pronësi, sipas dispozitave të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", të ndryshuar, rin-

darja e tokës sipas nenit 5 të ligjit nr.8312, datë 26.3.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", si dhe krijimi i titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore për-

fundojnë në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji) b) ish-ndërmarrjeve bujqësore, në zbatim të ligjit nr.57/2012, "Për përfundimin e procesit të kalimit në

REGJISTRIMI

Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë dërgon për regjistrim në ZVRPP vendimin gjyqësor përfundimtar për sipërfaqet e tokës të lirura nga fitimi, mbajtja dhe përdorimi i paligjshëm i tyre, që kalojnë në pronësi të shtetit, pas procedurave të realizuara sipas përcaktimeve të neneve 9 e 10, të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar". Pjesë e detyrueshme e këtij vendimi është planvendosja e ngastrës/ave.

Vlefshmërinë e titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore

Subjekte të përfitimit të tokës bujqësore në pronësi edhe të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore janë personat fizikë dhe juridikë vendës. Për krijimin dhe fitimin e titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore janë të vlefshme vetëm kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 255, datë 2.8.1991, të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore", të ndryshuar dhe në ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995 "Për kalimin në pronësi, pa shpërbllim, të tokës bujqësore", sipas procedurës së përcaktuar në udhëzimin nr.106, datë 23.2.1996, të ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit "Për procedurat e kalimit të tokës nga përdorimi në pronësi".

të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", të ndryshuar.

KOMISIONI

Qeveria urdhëroi komisionin vendor të vlerësojë aktet e marrjes së tokës në pronësi, të plotësuar nga kryetarët e bashkive, për bazueshmërinë ligjore të tyre dhe merr vendim për rikonfirmimin e tyre, në rastet kur: a) vërtetohet se familja bujqësore ose individi, në emër të të cilit lëshohet akti i marrjes së tokës në pronësi është subjekt i përfitimit të tokës bujqësore në pronësi, sipas ligjeve të sipërpërmendur; b) verifikohet se sipërfaqja, për të cilën është lëshuar akti i marrjes së tokës në pronësi, është objekt i trajtimit sipas ligjeve të sipërpërmendur dhe madhësia e saj është në përputhje me përcaktimet ligjore; c) janë krijuar në përputhje me procedurat dhe afatet e përcaktuara në ligjet e sipërpërmendura".

LIGJI NR.9948, DATË 7.7.2008

Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore. Kanë vlefshmëri ligjore titujt e pronësisë private mbi tokën, të krijuar te:

- Sipërfaqet që më 1.8.1991 kanë figuruar në regjistrat kadastrale, në zërin "Tokë bujqësore" dhe janë përfshirë në territoret e administruara nga ish-kooperativat bujqësore deri në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", të ndryshuar.
 - Sipërfaqet e tjera të tokave bujqësore, të administruara nga ish-ndërmarrjet bujqësore dhe institucionet e tjera shtetërore, të kaluara për ndarje për fshatrat e ish-kooperativave bujqësore vetëm me miratim të ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, deri në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr.8337, datë 30.4.1998 "Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave".
 - Sipërfaqet e tokave bujqësore të ish-NB-ve, sipas dispozitave të përcaktuara në ligjin nr.8053, datë 21.12.1995 "Për kalimin në pronësi, pa shpërbllim, të tokës bujqësore".
2. Nuk kanë vlefshmëri ligjore titujt e pronësisë në të gjitha sipërfaqet e tjera, që më 1.8.1991 nuk kanë figuruar në regjistrat kadastrale, në zërin "Tokë bujqësore", si pyje, livadhe, kullota, tokë pyjore dhe sipërfaqet të tjera të tokës jobujqësore, pavarësisht miratimit të ndryshimeve dhe kalimeve të këtyre zërave nga tokë bujqësore pas kësaj date.

Ministria e Mbrojtjes: Miratohen kriteret për përfitimin e ndihmës financiare

Ornela Manjani

Inteligjenca dhe mbrojtja, kategoritë që përfitojnë ndihma financiare

Aksidentet dhe humbja e jetës në punë, pagesat për familjarët

Qeveria përcakton kriteret dhe masën e përfitimit të ndihmës financiare për punonjësit e AISM (Punonjësit Civilë të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes). Garancia i vjen nga vendimi i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare në rast vdekjeje, sëmundjeje ose fatkeqësie për këta punonjës. Ky vendim vjen pas propozimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe si një detyrim për plotësimin e paketës ligjore për funksionimin e AISM.

VENDIMI

Vendimi i Këshillit të Ministrave përcakton qartë se punonjësi civil i AISM, ose familja e tij në rast vdekjeje, sëmundjeje të rëndë dhe për një kohë të gjatë ose dëmtimesh të rënda të pronës, si rezultat i një fatkeqësie natyrore përfiton ndihmë financiare të menjëhershme. Madje përcakton në mënyrë të detajuar dhe masën e këtij përfitimi, si dhe kriteret mbi të cilat është ngritur kjo masë përfitimi: "Punonjësi civil i AISM përfiton 6 paga mujore të muajit të fundit, kur vdes; 4 paga mujore të muajit të fundit, kur sëmuret rëndë dhe për një kohë të gjatë, e vërtetuar me raport mjekësor dhe 3 paga mujore të muajit të fundit, kur njëri nga familjarët në ngarkim të tij vdes ose sëmuret rëndë dhe për një kohë të gjatë, e vërtetuar me raport mjekësor. Njëherësh punonjësi civil i AISM përfiton 4 paga mujore të muajit të fundit,



kur pëson dëmtime të rënda të pronës, si rezultat i një fatkeqësie natyrore", thuhet në vendim. Njëherësh dhe kur punonjësi civil në detyrë i AISM vdes, kjo agjenci organizon ceremoninë e rastit dhe përballon shpenzimet e varrimit, sipas dokumenteve që justifikojnë shpenz-

imet. Ndërkohë që efektet financiare që rrjedhin nga zbatim i këtij vendimi do të përballohen nga fondi i veçantë në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Ndërsa, procedurat dhe dokumentacioni i nevojshëm për dhënie të ndihmës financiare, në zbatim të këtij vendimi përcak-

PAGAT

Punonjësi civil i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM) ose familja e tij, në rast vdekjeje, sëmundjeje të rëndë dhe për një kohë të gjatë ose dëmtimesh të rënda të pronës, si rezultat i një fatkeqësie natyrore, përfiton ndihmë financiare të menjëhershme, si më poshtë vijon:

- a. 6 paga mujore të muajit të fundit, kur vdes.
- b. 4 paga mujore të muajit të fundit, kur sëmuret rëndë dhe për një kohë të gjatë, e vërtetuar me raport mjekësor.
- c. 3 paga mujore të muajit të fundit, kur njëri nga familjarët në ngarkim të tij vdes ose sëmuret rëndë dhe për një kohë të gjatë, e vërtetuar me raport mjekësor.
- ç. 4 paga mujore të muajit të fundit, kur pëson dëmtime të rënda të pronës, si rezultat i një fatkeqësie natyrore.

2. Kur punonjësi civil në detyrë i AISM-së vdes, kjo agjenci organizon ceremoninë e rastit dhe përballon shpenzimet e varrimit, sipas dokumenteve që justifikojnë shpenzimet.

tohen me udhëzim të ministrit të Mbrojtjes.

PUNONJËSI CIVIL

Ministria e Mbrojtjes si propozuese e këtij vendimi që i vjen në ndihmë punonjësit civil të AISM do të marrë të gjitha masat për zbatimin e këtij vendimi, menjëherë sapo të botohet në Fletoren

Zyrtare. Vendimi i Këshillit të Ministrave për ndihmë financiare në rast fatkeqësie, vdekjeje apo sëmundjeje të punonjësit civil të AISM vjen si një kërkesë dhe detyrim ligjor për t'u ardhur në ndihmë punonjëse civile, kontribuues në mirëfunksionimin e kësaj agjencie.

TABELAT E KARBURANTEVE

MIE miraton standardin e ri: 30 ditë kohë për t'i zëvendësuar

Të gjitha pikat e tregtimit të karburanteve kanë 30 ditë kohë të ndryshojnë tabelat reklamuese të çmimeve, duke aplikuar standardin e ri, që sipas Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është në përputhje me Kodin Rrugor. Tashmë, ky dikaster ka miratuar një model të ri reklamimi dhe ndërcimi për pikat e karburanteve në akset rrugore kombëtare, i cili vjen në kuadër të aksionit për garantimin e sigurisë rrugore. Ndryshimi i tabelave të reklamimit u paralajmërua disa javë më parë edhe nga ministri, Damian Gjiknuri, i cili zhvilloi një takim me operatorët kryesorë të tregtimit të karburanteve në vend. Sipas Gjnkurit, kjo ka qenë një ndër pikat më problematike të trashëguara, pasi tabelat reklamuese për markat dhe çmimet, konfuzojnë shoferët e makinave dhe bëhen burim aksidentesh. Prej 4 javës Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka ndërmarrë një aksion për pastrimin e nyjeve dhe akteve kombëtare nga tabelat dhe aktivitetet e jashtëligjshëm. Që prej nisjes së këtij aksioni, janë pastruar akset: Vorë-Fushë Krujë, Elbasan- Rrogozhinë, si dhe është ndërhyrë në rrethrotullim Rrogozhinë- Plepa dhe nyjen e Milotit. Gjithashtu, në aksin rrugor Tiranë-Shkozë janë hequr 70 tabela dhe reklama informuese, ndërkohë që në javën e fundit u ndërhyrë në akset Fier-Vlorë dhe Lezhë-Shkodër.

BILANCI I TATIMEVE

Mbyllën 319 biznese, gjobiten 2450 të tjera, falen 62 mln euro

Drejtoria e Tatimeve ka bërë të ditur rezultatet e katër javëve të para të aksionit anti-informalitet. Gjatë kësaj kohe janë mbyllur 319 subjekte me shkelje, janë penalizuar rreth 2450 subjekte (22% e subjekteve të kontrolluara). Ka vijuar fshirja e detyrimeve në bazë të ligjit të faljes, ku janë falur rreth 8.6 miliardë lekë (62 milionë euro), ndërsa nga detyrimet e prapambetura janë mbledhur rreth 1.25 miliardë lekë. Ndërkohë, ka vijuar sensibilizimi për të mundësuar mbledhjen e detyrimeve të prapambetura, ku gjatë kësaj periudhe numri i subjekteve që kanë reaguar pozitivisht është 2035 dhe vlera është 1 miliardë e 250 milionë lekë. Ka filluar procesi i fshirjes automatike të detyrimeve përpara vitit 2010 dhe atë 2011-2014 dhe fshirja e detyrimeve me



kusht për periudhën 2011-2014, gjithashtu edhe fshirja e detyrimeve me kusht për periudhën 2011-2014 për ata tatimpagues që kanë paguar principalin. Më shumë se 13210 tatimpagues kanë përfituar dhe ky proces vijon ende. Si rezultat i këtij procesi, shumica e

detyrimit të falur është 559 miliardë lekë dhe përdorimi i kredisë për shlyerjen e detyrimeve në nivel principal është në vlerën e 1,101 miliardë lekëve. **HETIM TATIMOR DHE ZBATIMI** Strukturat e zbatimit kanë vijuar me verifikimin

në territor, janë verifikuar 11,166 subjekte ku 22% e tyre kanë rezultuar me shkelje dhe janë penalizuar. Janë futur në skemën e sigurimeve shoqërore gjatë katër javëve të para të aksionit 506 punonjës, që janë konstatuar të padeklaruar dhe janë mbyllur 3109 sub-

jekte të paregjistruar në organet tatimore, si dhe për shkelje të tjera si moslëshim kuponit për herë të dytë. Janë regjistruar 2941 subjekte të reja dhe janë aktivizuar 645 subjekte. Qendra e thirrjeve ka vijuar të ofrojë shërbimet në numrin e vënë në dispozicion për çdo problematikë dhe suport ndaj çdo tatimpaguesi, duke asistuar rreth 7,511 telefonues, si dhe përdorues të live chat. Për katër javët e para të fushatës është mundësuar përfundimi i 8,129 kontrolleve (nga zyra, vizita fiskale apo verifikime në terren) ku kontrollet nga zyra bëjnë 74 % të totalit. Këto kontrolle u shoqëruan me më shumë se 555 milionë lekë gjetje dhe raporti i gjetjeve me penalitete është në masën 73% me 27%. Rreth 1153 subjekte kanë ndryshuar përgjegjësinë tatimore, ku Tirana ka numrin më të madh me 641 subjekte, ndjekur nga Durrësi me 154 dhe Vlora me 93.

EDUKIMI DHE INFORMIMI

1. Shërbimi i tatimpaguesve ka asistuar ballë për ballë 32,376 tatimpagues.
2. Mbi 5,910 është numri i tatimpaguesve të kontaktuar për ligjin e faljeve.
3. Mbi 15,355 tatimpagues janë kontaktuar për të nxitur vetëkorigjimin.
4. Rreth 6,160 është numri i vizitave këshilluese të përfunduara.
5. Janë organizuar 32 takime me komunitetin e biznesit në territor.

DOSJA HABILAJ HETIMI

Gazetari italian: Saimiri për të cilin flitet në përgjime, duhet të jetë ish-ministri i Brendshëm

Gjykata e Katanias lë në burg Habilajn e 5 bashkëpunëtorët

Tentuan të trafikonin 3.5 tonë hashash drejt Italisë

Ina Allkanjari

Gjykata e Rivlerësimit e Katanias ka lënë dje në burg Moisi Habilajn dhe 5 bashkëpunëtorët e tij. 48 orë pas dëgjimit të pretendimeve të 6 prej të arrestuarve në kuadër të dosjes "Habilaj", gjykata vendosi mos ndryshimin e masës së sigurisë ndaj tyre. Ndërkohë gazetari italian i "Meridione-News", Dario De Luca (personi që publikoi dosjen e përgjimeve të grupit "Habilaj"), në një lidhje telefonike për "News24" ka shpjeguar masat e dhëna nga gjykata ndaj anëtarëve të grupit "Habilaj" dhe të dhëna të tjera në këtë dosje.

GJYKATA E RIVLERËSIMIT E KATANIAS

Gjyqtarët Iarato, Benanti dhe Catena kanë depozituar dje në mesditë në sekretarinë e gjykatës së Katanias vendimin e marrë ndaj të pandehurve Moisi Habilaj dhe bashkëpunëtorëve të tij. Organi i akuzës së Katanias ka paraqitur në seancën gjyqësore prova dhe fakte për përfshirjen e këtij grupi kriminal në trafikim ndërkombëtar të lëndëve narkotike. Prova të cilat kanë qenë bindëse për gjyqtarët, të cilët e refuzuan rekursin e paraqitur prej të pandehurve, duke dhënë masën e sigurisë "Arrest me burg". Në



Foto ilustruese

MASA E SIGURISË

Gjykata e Rivlerësimit e Katanias ka dhënë dje masën e sigurisë "Arrest me burg" për Moisi Habilajn dhe 5 bashkëpunëtorët e tij. Organi i akuzës së Katanias ka paraqitur në seancën gjyqësore prova dhe fakte për përfshirjen e këtij grupi kriminal në trafikim ndërkombëtar të lëndëve narkotike.

seancën e të martës avokati i Moisi Habilaj kërkoi heqjen e masës së sigurisë me pretendimin se nuk kishte prova për mbajtjen në burg duke apeluar për lirim. Arrestimi i Moisi Habilaj dhe bashkëpunëtorëve të tij, u bë i mundur pas 4 vite ndjekje dhe përgjime, ku u kapën në 3.5 tonë hashash që ata

trafikuan drejt Italisë. Në përgjimet e grupit "Habilaj" përmendej edhe Saimir Tahiri, ku prokuroria shqiptare kërkoi heqjen e imunitetit dhe arrestimin e ish-ministrit të Brendshëm.

GAZETARI ITALIAN I "MERIDIONEWS", DARIO DE LUCA

Gjatë një lidhje telefon-

Nezar Seiti: Me familjen Habilaj kam lidhje krushqie

Zbardhet dëshmia e Nezar Seitit, një prej personave të dyshuar si pjesëtar i grupit kriminal "Habilaj"

Nezar Seiti, një prej personave të dyshuar si pjesëtar i grupit kriminal "Habilaj", ka shpjeguar përpara oficerëve gjyqësorë lidhjen e tij me familjen Habilaj. Ai ka treguar se më Habilajt bashkëshortja e tij i ka kushërinj. "Me shtetasit Artan, Moisi dhe Florian Habilaj, kam lidhje krushqie, pasi bashkëshortja ime i ka kushërinj. Moisi më vizitoi kur kreuva një ndërhyrje në Itali. Vëllezërit i kam takuar kur jam kthyer në Shqipëri. Me Moisiun dhe Florianin takohem rrallë, ndërsa me Artanin më shpesh", ka shpjeguar Nezar Seiti. Seiti, i arrestuar mbrembjen e 19 tetorit, ka rrëfyer para prokurorëve se prej vitesh jetonte dhe punonte në Itali, por vinte shpesh në Shqipëri, për të vizituar prindërit në fshatin Gjorm. Për këtë shkak u gjend në

Vlorë, ku dhe u arrestua për llogari të prokurorisë së Katanias, me akuzën e trafikut të drogës në bashkëpunim. I arrestuari tjetër në Shqipëri, infermieri Armand Kocerri, edhe ky i dyshuar për përfshirje në klanin kriminal, nuk ka dhënë shpjegime, ndërsa motra dhe nëna e tij kanë mohuar të kishin dijeni për lëndën narkotike që u gjet dhe sekuestrua në shtëpinë e tyre. Sa i përket komunikimeve telefonike, rezultojn se pjesëtarët e familjes Habilaj, ishin shumë të kujdesshëm, pasi në dosjen e prokurorisë bie në sy fakti se për biseda, ata përdornin numra të regjistruar në emra të personave të tjerë. Oficerët e policisë po verifikojnë lidhjet e Habilajve me personat në emrat e të cilëve rezultojn të jenë regjistruar numrat e telefonit.



ike dje për "News24", gazetari i "MeridioneNews" Dario De Luca, që publikoi dosjen e përgjimeve të grupit "Habilaj", ka thënë se Gjykata e Rivlerësimit të Katanias ka vendosur mos ndryshimin e masës së sigurisë për të arrestuarit e dosjes "Habilaj", të akuzuar për trafik droge. I pyetur nëse

bëhet fjalë për një Saimir të dytë apo për ish-ministrin Saimir Tahiri, i cili përmendet në përgjime, gazetari italian tha se në aktet e prokurorisë së Katanias, Saimiri për të cilin flitet duhet të jetë ish-ministri i Brendshëm. De Luca, i pyetur për besueshmërinë e prokurorisë tha se hetimi

zgjat prej shumë kohësh dhe ka shumë prova, momentalisht ka mbi 12 të hetuar nga fashikujt. Për sa i përket arrestimeve të tjera, ai tha se duhet arrestuar Florian Habilaj. De Luca u shpreh se persona që janë arrestuar, nuk janë të rëndësishëm në botën e kriminalitetit pasi bëhet fjalë për ndërmjetës.

Gardiani 30-vjeçar drejtohte blerjen dhe shitjen e kokainës

Shpërndante drogë në burg, të përfshirë policë të tjerë

ITALI - Pas arrestimit të një polici të burgut të Brescias L.P., 30 vjeç me origjinë kalabreze, policia italiane zgjeron hetimet pasi dyshohet për përfshirje të policëve të tjerë. Gardiani 30-vjeçar akuzohet për shpërndarje droge, korrupsion dhe abuzim me detyrën. Në dosjen e të hetuarve janë përfshirë edhe persona të tjerë, një tjetër gardian burgu dhe dy të dënuar, edhe ata të akuzuar për shpërndarje. Ka qenë vetë policia e burgut që për rreth dy vjet ka kryer hetimet. Ajo që startoi nisjen e hetimeve ishte denoncimi i një të dënuari që pretendonte se ishte mashtruar. Pasi policia e burgut nisi he-

timet, zbuloi se 30-vjeçari kishte më shumë se një vit që drejtohte blerjen dhe shitjen e kokainës në burg. Mendohet se brenda kishte bashkëpunëtorë disa të dënuar. Ndërkohë jashtë furnizuesit ishin shqiptarë. Por për hetuesit rrugët e furnizimit kanë qenë dy. Kush blinte mallin paguante paratë me rrugë postare, falë ndihmës së atyre që qëndronin pas hekurave. Policia ka gjetur dëshmitarë për të konfirmuar këtë. Në gjykatë pritet dëshmia e një të paraburgosuri që kishte blerë drogë. Agjentët e tjerë, konsumatorë të mundshëm, mund t'i nënshtrohen analizave, duke rrezikuar masa disiplinore të rënda.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Sigurimi i jetës, kujdesit shëndetësor dhe siguracioni i shëndetit në udhëtim i punonjësve të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"**.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 23,694,000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Sigurimi i jetës, kujdesit shëndetësor dhe siguracioni i shëndetit në udhëtim i punonjësve të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 24 Nëntor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Kush bën vrasje, jeton në ferr". Kështu u shpreh arqipeshkvi i dioqezës Shkodër-Pult, monsinjor Angelo Massafra gjatë meshës së shenjtë në varrezat katolike të Rrmajit në Shkodër në ditën e Purgatorëve, që njihet si dita e përkujtimit të të vdekurve. Massafra u drejtua besimtarëve duke u thënë se ferri mund të jetohet edhe në tokë, por edhe pas vdekjes. Sipas tij, në tokë jeton në ferr ai që bën vrasje dhe fshihet si lepurush nëpër male. Monsinjor Massafra u kërkoi besimtarëve të krishterë që morën pjesë në meshën e kremtuar nga ana e tij që të jenë sa më afër Zotit dhe të bëjnë zgjedhjet e duhura, sepse jemi vetë ne që e kemi në dorë një gjë të tillë.

ARQIPESHKVI

"Vuajtjet e njerëzve nuk janë një ferr, sepse kalojnë me ndihmën e Zotit. Por, ka njerëz që jetojnë në ferr këtu në tokë, por edhe pas vdekjes, ashtu siç parrizi është edhe në tokë, edhe në qiell. Ai që bën një vrasje jeton në ferr apo jo, sepse fshihet si lepurush nëpër male. Më ka qëlluar para disa viteve kur shkova në një mal, dikund më doli një person përpara. Ju e dini se tek ne katolikët, faljen për një vrasje e ka vetëm Ipeshkvi. Shkova në mal dikund shumë larg dhe ky

Arqipeshkvi i Shkodrës: Kemi gjetur eshtrat e martirit durrsak, Jul Bonati

"Ai që bën vrasje jeton në ferr, sepse fshihet si lepurush në mal"

Massafra: Ja si fala një person që vrau për hakmarrje

personi më ndalon. Përshëndetemi dhe më thotë se dua të them diçka. Po i them. Më thotë se unë kam bërë vrasje dhe se jam fshehur këtu në mal. Ajo jetë është si në ferr apo jo. Më thotë se unë kam vrarë për hak, për të marrë hak. Kam vrarë një person, sepse ai më ka vrarë babain dhe unë kam marr hak ndaj tij dhe tani jetoj këtu. Më tha a më çliron nga ferri, sepse unë jetoj në ferr? I them a e di se je me fat, sepse vetëm ipeshkvi ka të drejtë ta japë faljen dhe po të kishte qenë një tjetër s'do kishte mundur. Po e di tha ndaj edhe po të them. Të lutem më tha më liron nga ferri, sepse kam bërë vrasje. Pra, ai e kishte kuptuar se edhe në tokë jetohet si në ferr, ndaj më kërkoi mua falje dhe që Kisha ta falte dhe në ato kushte ia dhashë faljen. Ajo që dua të them është që e



Angelo Massafra gjatë meshës në varrezat katolike të Rrmajit

kemi në vetë në dorë të zgjedhim se çfarë bëjmë dhe si jetojmë. Unë dua t'ju them se duhet që të jeni sa më afër Zotit, sepse shpirti juaj, ashtu si Jezusit do të ringjallet. Shpirti është i pavdekshëm, ndaj mos jetoni si në ferr dhe bëni zgjedhjet e duhura".

GJETJA E ESHTRAVE
Gjatë meshës, monsinjor

ndjekim rrugën e 38 martirëve tanë. Ju e dini se këtu ku jemi, disa janë vrarë. Kjo meshë e sotme (djeshme) është shumë afër 1-vjetorit të lumturimit të 38 martirëve. Pra, u bë një vit nga ajo ngjarje e madhe për gjithë ne të krishterët. Para dy ditëve na kanë ardhur eshtrat e don Jul Bonatit, martirit që është nga Durrësi. Eshtrat e tij janë gjetur në një varr familjar atje në Durrës dhe tashmë para dy ditëve kanë mbërritur këtu. Është shumë e rëndësishme për ne dhe ky është një lajm i mirë për të gjithë. Tashmë do t'i pastrojme ashtu siç duhet e më pas do t'i vendosim në vendin e duhur. Ne presim 1-vjetorin e lumturimit për ta kujtuar dhe për të shërbyer ai moment si një mesazh i fortë për të gjithë ne", - deklaroi Massafra.

SHKURT

Përdhunoj nusen e djalit, arrestohet

KORÇË - Një 48-vjeçar i shpallur në kërkim është arrestuar nga policia e Devollit, pasi akuzohet për "Marrëdhënie seksuale me dhunë me të mitur". Bëhet fjalë për Gjegji Begollin, banues në fshatin Miras, i cili është dënua me 5 vjet burg nga gjykata e Korçës (vendim i lënë në fuqi edhe nga Apeli në Tiranë). Ngjarja për të cilën akuzohet 48-vjeçari ka ndodhur në nëntor të 2013-ës. Sipas policisë, Begolli ka abuzuar seksualisht me të miturën K.G.j., e cila ishte nusja e djalit të tij.

Aksidenti rrugore, 3 të vdekur në 5 orë

DURRËS/FIER - Tre persona humbën djete në tre aksidente automobilistike të ndodhura në harkun kohor të 5 orëve në Fier dhe në Durrës. Një 23-vjeçarë vdiq te kthesa e Patosit në Fier, pasi makina me të cilin udhëtonte ajo dhe një 27-vjeçar, doli nga rruga dhe u përmbys në kanal. Vetëm dy orë më pas, një 72-vjeçar u përplas për vdekje nga një autobus në autostradën Tiranë-Durrës. Ndërsa në qytetin e Durrësit, treni aksidentoi 70-vjeçaren E.B., banuese në Rrëshbull.



British American Tobacco Albania sh.p.k.

Njofton se duke filluar nga data 06 Nëntor 2017, cmimet e reja maksimale të shitjes me pakicë për produktet e saj të duhanit do të jenë si vijon:

Nr	MARKA	Cmimi maksimal/paketë i shitjes me pakicë
1	Kent Nanotek (Infina)	300
2	Kent Demislms Neo	280
3	Kent Demislms Spektra	280
4	Kent HD Neo	300
5	Kent HD Infina	300
6	Kent HD Neo 10 cigare	150
7	Lucky Strike Red	230
8	Lucky Strike Blue	230
9	Like Strike Blue 10 cigare	120
10	Lucky Strike NFF King Size 6 mg	230
11	Lucky Strike NFF Demislms 6 mg	220
12	Lucky Strike NFF King Size 4 mg	230
13	Lucky Strike NFF Demislms 4 mg	220
14	Rothmans Leggera	230
15	Rothmans of London (Blue)	200
16	Rothmans of London (Sky Blue)	200
17	Rothmans of London (Silver)	200
18	Dunhill FC 7 mg	320
19	Dunhill FC 4 mg	320
20	Rothmans of London Demislms 6mg (Produkti i ri)	200
21	Rothmans of London Demislms 4mg (Produkti i ri)	200

*Cmimet shprehën në Lek

Njoftimi i mësipërm bëhet në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë të Financave Nr.6, datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar".

British American Tobacco Albania sh.p.k.
Tirane, Rr: "Kavajes", ish Kombinati Ushqimor
web: www.bat.com
office phone: +355 (0) 42 255084

Gjykata lë në burg Fatmir Meçon dhe bashkëpunëtorin e tij

U arrestua për shitje droge, polici: Jam përdorues, por i aftë të ruaj rendin e sigurinë



Polici i arrestuar, Fatmir Meço

DURRËS - Gjykata e Durrësit ka vendosur dje masën e sigurisë "Arrest me burg" për Fatmir Meçon, punonjës in e patrullës në komisariatit e policisë së Durrësit, i cili u arrestua pak ditë më parë, pasi akuzohet për prodhim dhe shitje droge si dhe për shpërdorim detyrë. E njëjta masë siguri u dha edhe për të arrestuarin tjetër (bashkëpunëtor), 19-vjeçarin Fitim Selaci nga Fushë-Kruja. I veshur me një kostum sportiv, me duar të kryqëzuara dhe kokën ulur është shfaqur dje në sallën e gjyqit, 33-vjeçari Meço nga fshati Gjerbës i Skraparit. Meço, i cili akuzohet të jetë pjesë e një grupi që merrej me trafikun e drogës i ka bafuar të gjithë me dëshminë e tij, kur ka thënë se hashashin që iu gjet në banesë e mbante për konsum vetjak dhe se pavarësisht kësaj, ishte i aftë të ruante rendin e sigurinë. Ndërkaq, prokurori i çështjes deklaroi se ish-policia, së bashku me persona të tjerë ka shitur lëndë narkotike në zonën e Kënetës dhe se ai e mbante drogën

në banesë të tij dhe me pas ua shpërndante personave të tretë, të cilët në mënyrë demonstrative e konsumonin duke u kthyer edhe në shqetësim për komunitetin. Nisur nga këto, prokurori kërkoi që të konsiderohet i ligjshëm arresti.

Gjykatësi: Sa kohë ke që punon në polici?
Polici: Prej dy vitesh e gjysmë.
Gjykatësi: A i deklarove ti policisë që je përdorues droge kur bërë betimin?
Polici: Po ju thashë. Jo se u ngatërrova nuk iu kam thënë gjë. E kam pirë me periudha të ndryshme, por nuk kam trafikuar drogë
Gjykatësi: Ti je bërë objekt shqetësimi në zonën e

Kënetës, iu shisje drogë një grupi të rinjsh që bënin shërre e shqetësonin komunitetin...
Polici: Kam shtëpinë aty, kam kaluar aty, s'kam tregtuar drogë...
Gjykatësi: Cili është misioni yt, a është të kapësh trafikantët e drogës?
Polici: Unë kam si mision ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike, kjo është detyra ime, jam i aftë ta bëj atë.
Gjykatësi: Po për të droguarit në zonë kishe informacione?
Polici: Kam kaluar në atë zonë se kam shtëpinë aty, por s'i njoh, s'kam lidhje me ta. **kl.ha.**

Dokumentacioni që duhet të dorëzoni brenda 10 nëntorit të këtij viti

Bursa në Bruksel për studentët e Universitetit të Tiranës

E drejta e studimit, çfarë përfitojnë fituesit

Voltiza Duro

Studentët e Universitetit të Tiranës kanë afat deri më 10 nëntor të këtij viti për të aplikuar për bursë studimi për semestrin e dytë të vitit akademik 2017-2018. Ky është njoftimi i publikuar ditën e djeshme në faqen zyrtare të këtij universiteti ku bëhet thirrje për aplikim. Në kuadër të programit Erasmus+, të interesuarit që plotësojnë kriteret mund të përfitojnë 3 muaj studime në Universitetin Saint-Louis në Bruksel, Belgjikë. Bursat do të përfshijnë kompensim mujor në vlerën 800 euro për studentët si dhe kostot e udhëtimit në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës. Të gjithë kandi-



Foto ilustruese

datët që do të përzgjidhen fitues, nuk do të paguajnë asnjë tarifë shkollimi dhe ndërkohë do të vazhdojnë të shlyejnë tarifat në universitetin e vendit të tyre. Këto bursa synojnë shkëmbimin e studentëve për 3 muaj studimi në nivelin Bachelor apo

Doktoraturë. Kandidatët e interesuar për bursa në nivelin Bachelor duhet të dorëzojnë këto dokumente pranë Rektoratit të UT-së: kurrikulumin (CV) në gjuhën angleze apo frënge, kopjen e pasaportës, vërtetimin e studentit, listën e notave, dësh-

minë e mbrojtjes së gjuhës angleze apo frënge në nivelin B1, një letër motivimi si dhe dokumentin "Learnig Agreement". Ndërsa aplikantët për bursa në nivelin Doktoraturë, bashkëgjitur me dokumentet e sipërmendura duhet të dorëzojnë edhe diplomën e listën e notave për ciklin Bachelor si dhe diplomën Master me listën e notave të përkthyer në gjuhën zyrtare anglisht apo frëngjisht.

APLIKIMI

Dokumenti Learning Agreement është një kontratë mes universitetit të origjinës së aplikantit dhe përcaktimit të lëndëve që do të zhvillojë në universitetin pritës. Aplikantët duhet të kenë kujdes dhe të plotësojnë vetëm seksionin e parë "Before the mobility", ku në tabelën A gjenden të

DOKUMENTACIONI

PËR NIVELIN BACHELOR

- o CV (në gjuhën angleze/franceze)
- o Kopje e pasaportës
- o Vërtetim studentit
- o Listë notash (e përkthyer në gjuhën (angleze/franceze))
- o Letër motivimi në gjuhën angleze apo franceze
- o Certifikata e gjuhës së huaj B1 (anglisht/ frëngjisht sipas programit të studimit)
- o Dokumenti Learning Agreement

PËR NIVELIN DOKTORATURË:

- o CV (në gjuhën angleze/franceze)
- o Kopje e pasaportës
- o Vërtetim studentit
- o Diplomë Bachelor
- o Listë notash Bachelor
- o Diplomë Master (e përkthyer në gjuhën (angleze/franceze))
- o Listë notash Master (e përkthyer në gjuhën (angleze/franceze))
- o Letër motivimi në gjuhën angleze apo franceze
- o Certifikata e gjuhës së huaj B1 (anglisht/ frëngjisht sipas programit të studimit)
- o Dokumenti Learning Agreement

përcaktuara lëndët dhe kreditet që do të marrin në universitetin pritës, ndërsa tabela B informon studentët se cilat prej lëndëve që do të zhvillojnë në Universitetin e Brukselit do të njihen në UT, pas periudhës së shkëmbimit. Për këtë arsye, kandidatët duhet të përzgjedhin të kryejnë në Universitetin Saint-Louis po ato lëndë që zhvillojnë në fakultetin në Shqipëri, e në këtë mënyrë lëndët dhe kreditet do të nji-

hen nga institucioni arsimor i origjinës. Nëse studentët dëshirojnë të shkojnë në Belgjikë vetëm për humtim, atëherë duhet ta përcaktojnë paraprakisht këtë në dokumentin e Learning Agreement. I gjithë dokumentacioni për aplikim për bursa studimi duhet të dorëzohet dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, pranë Drejtorisë së Komunikimit si dhe të skanuara përmes postës elektronike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇEM I APELITIT

SHPLLJE E VENDEVE VAKANTE

Kolegji i Posaçëm i Apelitit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin e Kuvendit nr.92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të kolegjit të Posaçëm të Apelitit", shpall vendet vakante për pozicionet:

1. SPECIALIST FINANCË/BUXHET

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:

- a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Ekonomi, Dega Financë.
- b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- c. Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në profesion.
- d. Të ketë njohuri në programet financiare si: Alpha/Financa 5 etj.

2. SPECIALIST I BURIMEVE NJERËZORE

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:

- a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
- b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- c. Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në fushën e burimeve njerëzore.

3. SPECIALIST IT

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:

- a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inxhinieri Informatike, Informatike, Teknologji informacioni etj.
- b. Të ketë të paktën 3 vite eksperience pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
- c. Të ketë njohuri shumë të mira në administrimin e sistemeve si Active Directory, Outlook Mail Client
- d. Të ketë njohuri bazë mbi pajisjet e rrjetit dhe infrastrukturën e rrjetit.
- e. Të ketë njohuri bazë për panelet e administrimit të faqeve web (Wordpress, Drupal, Joomla etj).
- f. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

4. SPECIALIST PROTOKOLL/ARKIVE

Kandidati duhet të plotësojë këto kritere:

- a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
- b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- c. Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për të pajisur me Certifikatë Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për të përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 6 Nëntor deri më 10 Nëntor 2017 në një nga formatet e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: **Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.**
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: **"Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 10 Nëntor 2017, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.**
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 6 Nëntor deri më 10 Nëntor 2017 në adresën: **info@kpa.al.** KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore ne fuqi;
6. Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
7. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Kostreci: Propozimi i presidentit Trump, pjesë e reformës së emigracionit

Lotaria Amerikane, kongresi nis shqyrtimin për mbylljen e programit

"Nuk e besoj që të prekë aplikantët për këtë vit"



GAZETARJA E VOA-S

"Nuk e besoj, por nuk mund ta di me siguri. Po ta shikosh nga kohëzgjatja që ka marrë diskutimi i kësaj pakete, është dorëzuar në senat në shkurt dhe po shqyrtohet sot. Ky nuk është një veprim i nxituar, por pjesë e një pakete të madhe të reformës së emigracionit dhe reformat duan kohë të shqyrtohen nga ana e kongresit dhe pastaj kalojnë nga Shtëpia e Bardhë", - shpreh gazetarja e VOA-s.

Propozimi i presidentit të SHBA-ve, Donald Trump për t'i dhënë fund programit të Lotarisë Amerikane është marrë në shqyrtim nga kongresi ditën e djeshme. Ky program është pritur edhe me shumë interes nga vendi ynë e kandidatët që kanë aplikuar për DV-2019 janë në pritje të një përgjigjeje përfundimtare nëse do të preken apo jo nga vendimi që do të merret. Por në një lidhje telefonike me "News 24", gazetarja e "Zërit të Amerikës", Keida Kostreci thotë se nuk e beson që të penalizohen aplikantët e lotarisë për këtë vit, po gjithësi sipas saj, duhet pritur deri në shqyrtimin e propozimit nga kongresi. "Nuk e besoj, por nuk mund ta di me siguri. Po ta shikosh nga kohëzgjatja që ka marrë diskutimi i kësaj pakete, është dorëzuar në senat në shkurt dhe po shqyrtohet sot. Ky nuk është një veprim i nxituar, por pjesë e një pakete të madhe të reformës së emigracionit dhe reformat duan kohë të shqyrtohen nga ana e kongresit dhe pastaj kalojnë nga Shtëpia e Bardhë", - shpreh gazetarja e VOA-s.

shëm të SHBA-ve. Dhe më parë, Ambasada Amerikane ka theksuar që kandidatët duhet të tregohen shumë të kujdesshëm në leximin e kritereve dhe duhet të plotësojnë domosdoshmërisht një

prej tyre, pra ose të kenë përfunduar arsimin e mesëm, ose të kenë eksperiencat e punës të përcaktuara. "Siç e thashë, në qoftë se propozimi ose ajo që do presidenti realizohet, do ishte një

sistem i bazuar tek merita, si i Kanadasë. Për sa i përket opinionit publik, nuk është një term që ka jehonë shumë të madhe", - përfundon prononcin gazetarja e VOA-s. Në më pak se tre vjet janë

mbajtur tri seanca dëgjimore lidhur me ekspozimin ndaj rrezeve të sigurisë kombëtare nga programi i Lotarisë Amerikane. Në vitin 2013, inspektori i përgjithshëm i Departamentit të Shtetit dëshmoi se programi paraqet rrezeqe për sigurinë kombëtare nga zyrtarë armiqësorë të zbulimit, kriminelë dhe terroristë që mund të përpjajnë pa përdorin programin për të hyrë në Shtet dhe Bashkuara si banorë të përhershëm. Por demokratët thonë se programi i cili favorizon vendet që nuk kanë nivele të mjaftueshme imigrimi në Shtet dhe Bashkuara, i shërben diversitetit të vendit. Lotaria Amerikane çdo vit ofron rreth 50 mijë viza për të gjithë ata që duan të jetojnë e të punojnë në "Tokën e premtuar", ku pjesë e programit është edhe vendi ynë. Kandidatët shqiptarë kanë të drejtë të marrin 7% të vizave që jepen nga Departamenti Amerikan i Shtetit për këtë program. Por aplikantët duhet të presin deri në marrjen e një vendimi nga kongresi në lidhje me fatin e lotarisë.



TRUMP: TI JEPET FUND ÇMENDURISË SA MË SHPEJT

Presidenti i SHBA-ve, Donald Trump, fill pas akteve të së martës në Nju Jork i bëri thirrje kongresit që t'i japë fund programit të Lotarisë Amerikane. "Po filloj procesin e eliminimit të programit të Lotarisë Amerikane. Do t'i kërkoj kongresit të nisë menjëherë punën për t'i dhënë fund këtij programi. Lotaria e diversitetit tingëllon mirë, por nuk është diçka e mirë. Ne kemi qenë kundër. Populli amerikan është i etur për lidhshpë e jo për përçarje. Presidenti duhet të lërë mënjatë postimet e të udhëheqësve. Mënyra më e mirë për ta bërë këtë është të rrisë financimet kundër terrorizmit. Kështu do të mund të ndihmojmë", - tha Trump. Kreu i Uashingtonit bëri thirrje për masa më të repta emigracioni, duke pohuar se së shpejti do t'i jepnin fund çmendurisë. Ai akuzoi kreun e demokratëve në senat, Chuck Schumer si fajtorin për ekzistencën e programit të Lotarisë Amerikane. Ndërkaq, Schumer dhe senatorët tjerë demokratë u shprehën se presidenti po politizon sulmin e ndodhur në Nju Jork.

UMSH: Dokumentacioni që duhet të dorëzoni Provimi i Shtetit për studentët e Mjekësisë, ja kush mund të aplikojë



nga prokuroria që nuk ndiqen penalisht, si dhe dy fotografi. Më tej studentët duhet të dorëzojnë edhe librezën e Praktikës Profesionale të lëshuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë. Ndërsa të gjithë ata kandidatë që janë regjistruar në sezonet mëparshme zyrtarisht për këtë provim, dhe nuk kanë mundur ta kalojnë duhet të bëjnë rinovimin e disa prej

dokumenteve. Respektivisht duhet të dorëzojnë dëshminë e penalitetit, raportin mjeko-ligjor, e vërtetimin që nuk ndiqen penalisht. Në provimin e shtetit, kanë të drejtë të hyjnë të gjithë mjekët e diplomuar, të regjistruar provizorisht tek Këshilli Kombëtar dhe kanë përfunduar praktikën profesionale 3 muaj, të parashikuar në rregulloret e Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë.

DOKUMENTACIONI PËR PROVIMIN E SHTETIT NË KËSHILLIN KOMBËTAR TË URDRHIT TË MJEKËVE TË SHQIPËRISË:

1. Kërkesë me shkrim për regjistrim
2. Formulari i aplikimit
3. Fotokopje e letërnjoftimit;
4. Fotokopje e noterizuar e diplomës së studimeve universitare;
5. Fotokopje e noterizuar e suplementit të diplomës e lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë, në mungesë të tij lista e notave e noterizuar.
6. Dorëzimi i librezës së Praktikës Profesionale (e plotësuar) lëshuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë;
7. Raporti mjeko-ligjor;
8. Dëshmi penaliteti;
9. Vërtetim nga prokuroria që nuk është në ndjekje penale;
10. 2 fotografi të formatit të pasaportës.

Nis rindërtimi i shkollës "Servete Maçi" Veliq: I japim fund mësimin me dy turne

Ka nisur rindërtimi nga e para i shkollës "Servete Maçi" në kryeqytet, e cila do t'u ofrojë nxënësve më shumë hapësira dhe do t'i japë fund mësimin me dy turne. Kryebashkiaku Erion Veliq u shpreh se falë investimit, shkolla e re do të jetë më e madhe dhe do të krijojë kushtet e nevojshme për të qenë edhe një shkollë që do t'i shërbejë komunitetit të banorëve që jetojnë në atë lagje, për të zhvilluar aktivitetet jo shkollore. "Ka nisur prishja e shkollës së vjetër, një shkollë, e cila është themeluar si Shkolla e Vashave në vitin 1916; pra, pas 101 vjetësh rrezohet e vjetra për të krijuar të rene, për ta kaluar të gjithë shkollën vetëm me një turn dhe për të përfunduar një hapësirë, e cila do të mirëpresë një pafundësi talentesh që vijnë në shkollën e muzikës", - tha Veliq. Ai theksoi se këtë vit do të startojë edhe zbatimi i projektit të ndërtimit të 16 shkollave në part-neritet me sipërmarrësit privatë, që do t'i japë fund përfundimisht problemit të mësimin me dy turne në Tiranë. Ndërsa deputeti i PS, Ervin Bushati falënderoi Bashkinë e Tiranës për vëmendjen që i ka kushtuar zhvillimit të infrastrukturës në Tiranë dhe në mënyrë të veçantë zhvillimit dhe arsimit.



Brenda datës 10 nëntor të gjithë studentët e mjekësisë që kanë përfunduar praktikën profesionale duhet të paraqiten pranë Urdhrit të Mjekut për të bërë regjistrimin për provimin e certifikimit. Për të kryer këtë procedurë kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet që janë përcaktuar për regjistrimin në provimin e shtetit, pranë institucionit përkatës. Kështu që studentët e interesuar duhet të paraqesin një kërkesë me shkrim për regjistrim, formularin e aplikimit që duhet ta shkarkojnë nga faqja e internetit www.urdhrimjeko.org, alsi dhe një fotokopje të letërnjoftimit personal. Gjithashtu, kandidatët duhet të dorëzojnë edhe fotokopjen e noterizuar të diplomës së studimeve universitare dhe një fotokopje të noterizuar të suplementit të diplomës së lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë. Bashkangjitur me dokumentet e mësipërme, aplikantët duhet të paraqesin dëshminë e penalitetit e një vërtetim

SiCRED, e vetmja shoqëri sigurimi me katër paketa për Sigurimin e Jetës së Nxënësve dhe Studentëve

Duke filluar nga 1,200 lekë në vit, Sigurimi i Jetës dhe Shëndetit të Nxënësve e Studentëve bëhet i prekshëm për çdo të ri/re shqiptar/e.

Sezoni i ri shkollor e akademik ka filluar dhe mijëra nxënës i janë rikthyer bankave të shkollës e qindra të tjerë janë ulur për herë të parë në to. Studentët të shumtë i janë rikthyer auditorëve të fakultetit e për qindra të tjerë janë hapur dyert e universitetit në ndjekjen e pasioneve, ëndrrave dhe dëshirave të tyre.

Duket që në këtë periudhë të vitit jeta bëhet akoma më e larmishme dhe sigurisht që të papriturave e saj askush nuk i di. Secili prej nesh, në mendjen e tij është ndeshur me pyetje rreth përbalimeve financiare në rast të ndodhjes së një ngjarjeje fatkeqe.

Mos u shqetësoni! Ashtu

si në të gjithë botën, edhe në Shqipëri kemi mundësinë e sigurimit të jetës dhe shëndetit, kemi mundësinë e mbrojtjes financiare në rastin e ndodhjes së një ngjarjeje të papritur. Me një staf të specializuar vetëm në fushën e sigurimit të jetës, SiCRED ofron shërbim dhe paketa me mbulime shumë të mira për çdo të siguruar.

Paketat e sigurimit "Jetë Nxënësi dhe Studenti", ofrojnë mbulim të shpenzimeve mjekësore në çdo rast të papritur shëndetësor apo aksidental. Duke marrë parasysh aktivitetin e përditshëm të nxënësve dhe studentëve, kjo kontratë siguri ofron një gamë të gjerë mbulimesh dhe përfitimesh:

■ Mbulimit të shpenzimeve mjekësore në rast aksidenti

■ Sigurimit të sëmundjeve kritike

■ Dëmshtëprblimit për frakturat dhe paafhtësi

■ Etj.

Përveç kësaj, kontrolli vjetor i shëndetit, nëpërmjet paketave të ekzaminimeve, është opsioni më i mirë i parandalimit të të papriturave. Kryerja e paketave të check up-it për nxënësit dhe studentët ofrohet në spitalet dhe klinikat më të mira private, pjesë e rrjetit mjekësor të SiCRED.

PËRFITIME TË TJERA:

Karta SiCRED

Pajisja me kartën e sig-

urimit, bën që të gjithë klientët të trajtohen në mënyrë preferenciale gjatë kohës që marrin një shërbim mjekësor të caktuar në një nga klinikat apo spitalet e rrjetit SiCRED. Kjo kartë mundëson zbritje deri në 60% për shërbimet mjekësore të marra jo vetëm në Shqipëri, por edhe në spitalet më prestigjioze të Europës.

NDËRGJEGJËSIMI PËR SIGURIM

Ndonëse ka kaluar më tepër se një dekadë, që kur tregu i sigurimeve në Shqipëri operon edhe në fushën e sigurimit të jetës dhe shëndetit, ende vërehet një interes dhe kujdes i ulët që qytetarët shqiptarë tregojnë ndaj sig-

urimit të jetës së tyre, kjo krahasuar edhe me vendet e rajonit.

SiCRED, me produktin e sigurimit "Jetë Nxënësi dhe Studenti" risjell sërish në vëmendjen tuaj rëndësinë e të qenit i siguruar dhe rëndësinë e kujdesit parandalues.

Edhe këtë vit, fokus i këtij produkti janë shkollat dhe universitetet private e shtetërore, të cilat dita ditës po shprehin interesin e tyre në rritje për sigurimin e nxënësve dhe studentëve.

Me punën e palodhur të SiCRED dhe me dashamirësinë e stafit drejtues të kopshëve, shkollave, universiteteve është arritur që shumë prej tyre t'i ofrojnë

nxënësve dhe studentëve një paketë sigurimi të integruar me programin e studimeve.

Ndërgjegjësimi për sigurim është i nevojshëm për aq sa do duam që financat tona të jenë më të stabilizuara.

PËRSE DUHET TË ZGJIDHNI SiCRED?

Nëse dëshironi zgjedhje të larmishme për shëndetin tuaj, me mbulime shumë të mira, nëse dëshironi që produktin e jetës dhe shëndetit tuaj ta blidh në një kompani sigurimi me staf të specializuar vetëm në këtë fushë, nëse dëshironi që shërbimi të ofrohet me korrektesë dhe etikë të lartë profesionale atëherë zgjidhja është vetëm SiCRED!

4 Paketa Sigurimi të Jetës së Nxënësve dhe Studentëve

Sigurimi i Jetës së Nxënësve				Sigurimi i Jetës së Studentëve		
Përfitimet	Paketa 1 Mosha 3 - 18 vjeç	Paketa 2 Mosha 3 - 14 vjeç	Paketa 2 Mosha 14 - 18 vjeç	Përfitimet	Paketa 1 arsimi universitar	Paketa 2 arsimi universitar
Shuma maksimale e Përfitimeve	600,000 Lekë	600,000 Lekë	600,000 Lekë	Shuma maksimale e Përfitimeve	1,200,000 Lekë	1,200,000 Lekë
Sigurim Jete	Ofrohet	Ofrohet	Ofrohet	Sigurim Jete	Ofrohet	Ofrohet
Mbulim shpenzime mjekësore në rast aksidenti	Ofrohet	Ofrohet	Ofrohet	Mbulim shpenzime mjekësore në rast aksidenti	Ofrohet	Ofrohet
Përfitime për frakturat	Ofrohet	Ofrohet	Ofrohet	Përfitime për frakturat	Ofrohet	Ofrohet
Përfitime për paafhtësitë	Ofrohet	Ofrohet	Ofrohet	Përfitime për paafhtësitë	Ofrohet	Ofrohet
Përfitim për sëmundje kritike	Ofrohet	Ofrohet	Ofrohet	Përfitim për sëmundje kritike	Ofrohet	Ofrohet
Paketë me Ekzaminime Mjekësore	Nuk ofrohet	Paketa check up	Paketa check up	Paketë me Ekzaminime Mjekësore	Nuk ofrohet	Paketa check up
Spitalet dhe Klinikat ku mund të kryhet paketa e analizave		<ul style="list-style-type: none"> Spitali Amerikan (Tiranë, Durrës, Fier) Spitali Gjerman Klinika "Orthodokse" Tiranë Klinika "Italiane" Tiranë Klinika "ABC" Tiranë Poliambulanca "At Luigji Monti" Tiranë Klinika "Kristi" Korçë Klinika "Jeta" Fier 	<ul style="list-style-type: none"> Spitali Amerikan (Tiranë, Durrës, Fier) Klinika "Italiane" Tiranë Laboratori "Intermedica" Tiranë Klinika "Harrison" Tiranë (Tiranë, Elbasan, Lushnjë) Klinika "Unison" Tiranë Klinika "Kristi" Korçë Klinika "Italmecade" Shkodër 	Spitalet dhe Klinikat ku mund të kryhet paketa e analizave		<ul style="list-style-type: none"> Spitali Amerikan (Tiranë, Durrës, Fier) Klinika "Italiane" Tiranë Laboratori "Intermedica" Tiranë Klinika "Harrison" Tiranë (Tiranë, Elbasan, Lushnjë) Klinika "Unison" Tiranë Klinika "Kristi" Korçë Klinika "Italmecade" Shkodër
Karta e Sigurimit	Përfshirë	Përfshirë	Përfshirë	Karta e Sigurimit	Përfshirë	Përfshirë
Afati i sigurimit	1 vit	1 vit	1 vit	Afati i sigurimit	1 vit	1 vit
Primi i sigurimit vjetor	1,200 Lekë	3,000 Lekë	3,000 Lekë	Primi i sigurimit vjetor	2,000 Lekë	4,500 Lekë

Dega Tiranë
Tel: +355 4 22 37 549
e-mail: shilje@sicred.com.al

Dega Fier
Cel: +355 69 40 88 721
e-mail: fier@sicred.com.al

Dega Vlorë
Cel: +355 69 70 76 621
e-mail: vlore@sicred.com.al

Dega Gjirokastrë
Tel: +355 84 26 90 19
e-mail: gjirokaster@sicred.com.al

Për më tepër informacion na kontaktoni në:
Zyrat Qendrore
Tel: +355 4 22 37 549
e-mail: contact@sicred.com.al

Dega Durrës
Cel: +355 69 60 65 916
e-mail: dures@sicred.com.al

Dega Elbasan
Cel: +355 69 70 10 736
e-mail: elbasan@sicred.com.al

Dega Shkodër
Cel: +355 69 60 65 917
e-mail: shkoder@sicred.com.al

Dega Korçë
Cel: +355 69 20 36 691
e-mail: korce@sicred.com.al

48-vjeçari falsifikonte etiketat në gjuhën greke

Zbulohet punishtja ku falsifikohesh vaj ushqimor, arrestohet pronari Kosta Fshati

KORÇË – Policia e Korçës ka zbuluar një punishte ku falsifikoheshin produkte ushqimore. Në kuadër të operacionit të koduar "ALKIS", është arrestuar pronari i punishtes, në të cilën prodhonte me etiketa në gjuhën greke dhe shiste vaj ushqimor në mënyrë të paligjshme, një pjesë e sasisë së të cilit dyshohet të jetë mall kontrabandë. Mësohet se vaji

që ambalazhohej në këtë punishte të 48-vjeçarit Kosta Fshati (rezulton të jetë dënuar në vitin 2010 për prodhim të paligjshëm të artikujve dhe mallrave industriale), shitej në supermarketet e Korçës me mbishkrim në gjuhën greke: "Extra virgin Olive Oil" dhe "Olive Oil". Burime zyrtare nga poli-



Vaji i sekuestruar në Korçë

cia e qytetit juglindor dje bënë me dije se 48-vjeçari u kap në flagrancë, pasi në një punishte në pronësi të tij, në lagjen nr. 10, u gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale: 5 depozita metalike dhe plastike të përmasave të ndryshme; 1300 litra vaj ushqimor me mbishkrime greke i dyshuar si kontrabandë; 1500 etiketa në gjuhën greke me mbishkrime të ndryshme; 494 kuti metalike dhe plastike të kapaciteteve 0.25, 0.5, tre, pesë dhe dhjetë litroshe me mbishkrim në gjuhën

greke "Extra virgin Olive Oil" dhe "Olive Oil"; 1180 shishe e bidoma plastike dhe metalike, 0.5, tre, pesë dhe dhjetë litroshe me mbishkrime greke, si dhe 17 fuçi plastike bosh 60 litroshe. Nga hetimet e kryera në lidhje me këtë rast dyshohet se këtë punishte, Kosta Fshati e përdorte për prodhimin dhe ambalazhimin e vajit ushqimor në mënyrë të paligjshme, duke përdorur etiketa në gjuhën greke me mbishkrime të ndryshme me qëllim shitjen e tij në tregun



Policia akuzon dhe ka shpallur në kërkim bashkëpunëtorin me mbiemrin Mata

Vrau avokatin Zafiropoulos për 3 mijë euro, zbulohet identiteti i shqiptarit

Egla Xhemali

GREQI

Policia greke ka publikuar fotën dhe emrin e 32-vjeçarit shqiptar të arrestuar në Greqi, si i dyshuari kryesor për vrasjen e avokatit të njohur grek Mihalīs Zafiropoulos, më 12 tetor në Athinë. Sipas mediave greke, ai rezultoi me disa emra dhe mbiemra, por nuk ka një identitet të qartë. Mbiemri i tij një herë jepet si Ibrahim, pastaj Brahimaj apo Brahimasi, kurse emri, Kastriot, Lavdërim, Mikel. Po kështu edhe për prindërit përmenden disa emra. Sipas policisë nuk është e qartë as datëlindja e tij, pasi në komunikatën e policisë jepen tri vite të mundshme, 1985, 1989, 1991, ndërsa vendlindja është Shqipëri. Për ngjarjen akuzohet edhe një tjetër i ri shqiptar, i cili është shpallur në kërkim. Ai quhet Aleksandro,



Mihalīs Zafiropoulos

Aleksandros apo Eno, me mbiemrin Mata, i lindur në Shqipëri, më 14 janar 1987. Ditën e djeshme, mediat greke kanë publikuar edhe videon e arrestimit të shqiptarit, i cili ka pranuar autorësinë e vrasjes së avokatit, ndërsa ka theksuar se është porositur dhe paguar në vlerën e 3000 eurove për këtë vrasje. 32-vjeçari shqiptar, i cili dyshohet si autori i vrasjes së avokatit të njohur më 12 tetor ka deklaruar para policisë se: "Unë nuk doja ta vrisja avoka-

tin Mihal Zafiropoulos, doja vetëm ta trembja". Mediat greke ditën e djeshme kanë publikuar videon e arrestimit të shqiptarit, i cili ka theksuar se është porositur dhe paguar në vlerën e 3000 eurove për këtë rast. Në materialin e publikuar dëgjohen zërat e policëve që thërresin "Policia, policia! Ndal, policia! Mbaj duart mbi timon! Mos lëviz, policia! Mos lëviz, mbaj duart mbi timon!", duke u kërkuar shqiptarit të ndalojë makinën. Dy ditë më parë burime për "Gazeta shqiptare" bën me dije se shqiptarët e marrë në pyetje për ngjarjen janë Albert Bako, Olti Dulçe dhe një tjetër me emrin Klodian. Ditën e mërkurë u raportua po ashtu se autori i vrasjes është një 32-vjeçar i arratisur nga burgu i Kasandrës. Ai kishte ikur me leje nga burgu, por nuk ishte kthyer më, duke kryer edhe krimin. Ndërkaq thuhet se urdhri për vrasjen e avokatit grek ishte dhënë nga burgu i Koridhalosë.

2 milionë euro në vit nga buxheti për pagat

Haradinaj: Qeveria e Kosovës me 50 zëvendësministra dhe 200 këshilltarë

KOSOVË - Kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj u ka gjetur punë 16 këshilltarëve në kabinetin e tij, përdërisa njëri nga ministrat e tij në kabinet tashmë i ka "rehatuar" 7 këshilltarë politikë dhe dy asistente ekzekutive. Nga 7 deri në 10 këshilltarë pritet t'i kenë edhe 20 ministrat e tjerë të kësaj qeverie, përdërisa paga e një këshilltari të ministrit shkon në 600 euro ndërsa këshilltarët e kryeministrit marrin pagë mujore prej rreth 1500 eurosh. Sipas një kalkulimi të thjeshtë del se për pagat e këshilltarëve të kryeministrit dhe të ministrave brenda vitit nga buxheti i Kosovës shpenzohen rreth 2 milionë euro, shkruan

"Zëri". Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në uebfaqen e këtij dikasteri qeveritar tashmë ka publikuar emrat e 7 këshilltarëve politikë, si dhe të dy asistentëve administrative. Përveç numrit të madh të ministrave, qeveria e Kosovës do të ketë rreth 50 zëvendësministra, të cilët po ashtu kanë të drejtë të emërojnë asistentë. Në shtator u bënë me dije anëtarët e stafit që do të punonin me kryeministrin. Si shef i stafit të zyrës së kryeministrit është Avni Arifi, kurse funksionin e këshilltarit po e ushtrojnë Arbër Vllahu, Haki Shatri, Jahja Lluka etj.

REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST (CONSULTING COMPANY)

ALBANIA

CITIZEN - CENTRIC SERVICE DELIVERY PROJECT
Loan Agreement Project ID No. 8521

Assignment Title: **Advisory Support for the Validation of e-Services**

Ref. No. **ALB-8521/CS/CQ/3.10.01**

Under the Innovative Good Governance priority, the Program "Innovation against Corruption: Building a Citizen Centric Service Delivery Model in Albania" (ISDA), launched in April 2014 and led by the Minister of State of Innovation and Public Administration (MIPA), entails a multilayered reform that focuses on key administrative central government public services to reduce the time and burden for citizens and businesses and improve service delivery quality, transparency and efficiency by using innovative solutions and ICT.

As part of the reform, in October 2014, ADISA, the Agency for the Delivery of Integrated Services in Albania, was created by a Decision of the Council of the Ministers.

To support ISDA Program implementation, the Government of Albania has received key financing from the World Bank under the Citizen Centric Service Delivery (CCSD) Project.

The program aims to improve public service delivery in Albania through a citizen-centric model where central government public services will be provided in an integrated fashion. In terms of the face-to-face channel, the model of the service delivery includes (under ADISA's management) **citizen service centers** established in municipalities, with the largest to be established in Tirana, to offer centralized access to 300+ public services of 15+ public institutions in a single location. Results of key activities linked to the project development objective will be measured through five Disbursement Linked Indicators (DLIs).

DLI #1 (Number of online services with Level 3 automation) measures the number of transactional administrative services provided online with two-way communication, including e-payment and e-filing.

In this framework, ADISA is seeking to hire a qualified Consulting Firm experienced in validating the status of Level 3 (and Level 4) services, and in assessing e-Government programs and ICT implementation in the public sector, with a focus on e-Gov portal applications and online services (further on referred to as 'Consultant'). The Consultant will be responsible for:

- Reviewing and validating the status of online services provided through e-Albania Portal using the UN 2014 framework
- Assessing the performance of several key services through interactions with service providers (government institutions) and beneficiaries (citizens and/or businesses); and
- Reviewing the "e-Service registers" maintained by NAIS and ADISA, and providing a comparative analysis of key findings of this assessment and registry contents to suggest possible improvements.

The Project Management Unit now invite eligible "Consultant" to indicate their interest in providing the Services. Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services.

The Consultant team will consist of one **Team Leader**, who will also work as a key expert (e-Government Specialist and ICT Auditor) a **Key Expert**, and a **Legal Expert** to perform the activities highlighted in this ToR. The consulting firm will have the following qualifications:

1. At least seven (7) years of consulting experience with a focus on e-Government/ICT system design, implementation and assessments, and IT Audit assignments;
2. At least two (2) similar contracts successfully carried out within the last five years with certificates of satisfaction issued by the contracting authority;
3. In-depth knowledge and understanding of ICT and e-Governance development issues;
4. Proven experience in the development of large ICT projects and design of e-Government architecture (including portals and online services);
5. Strong skills and knowledge of international standards and control frameworks (e.g., CobiT, ISO 27001/27002) and will be essential;
6. Experience in World Bank funded projects related to this assignment will be an advantage;
7. Fluency in English language, spoken and written (for all members of the team); and
8. Key staff with necessary qualifications and experience to successfully carry out all the tasks and deliverables of this assignment. These include but not limited to the following:

The **Team Leader** (e-Gov Specialist and ICT Auditor) shall possess the following qualifications:

1. Masters degree or demonstrated experience in informatics, engineering or related fields;
2. Minimum of ten (10) years professional experience;
3. Minimum of seven (7) years of experience in the design, implementation, and assessment of e-Gov portals for online service delivery (especially transactional and connected services) working with Government institutions;
4. At least five (5) years of experience of ICT Audit in corporate or public sector; and
5. ICT Audit qualification (Certified Information Systems Auditor or equivalent).

The **Key Expert** shall possess the following qualifications:

1. University degree in informatics, engineering, or related fields;
2. Minimum of five (5) years of experience in dealing with e-Gov portals for online service delivery (especially transactional and connected services) and assessment of service provider performance and citizen feedback; and

The **Legal Expert** shall possess the following qualifications:

1. University degree in law.
2. Minimum of five (3) years of experience in the IT related fields and /or e-services

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's Guidelines: Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers (January 2011 edition, revised July 2014) ("Consultant Guidelines"), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.

The Consultant will be selected in accordance with Consultant Qualifications method set out in the Consultant Guidelines.

Further information can be obtained at the address below during office hours from 08:00 to 16:00, Mondays to Thursdays, and from 08:00 to 14:00 on Fridays

The notification is posted on the website of the Agency for the Delivery of Integrated Services in Albania (ADISA): www.adisa.gov.al.

Expressions of interest (CVs, Letter of Interest and documentary evidence for fulfilling the qualifications) must be delivered in a written form to the address below in person, or by mail, or by e-mail by November 17, 2017, at 12.00 local time

Project Management Unit
Blvd: Zhan d'Ark,
Ish shtëpia e oficerave, Kati V-te
Tirana, Albania
E-mail: roland.larashi@inovacioni.gov.al
and ccsdprojectalbania@gmail.com

Dokumentet duhet të dorëzohen brenda tre muajve për këstin e parë dhe të dytë

Ornela Manjani

Ish-të përndjekurit, 3000 trashëgimtarët që përfitojnë dëmshpërblim

Ministria e Financave: Fëmijët dhe nipërit e ish-të dënuarve të plotësojnë dosjet

Ministria e Financave ka publikuar listën e kategorisë jo parësore në radhët e ish-të përndjekurve politikë që mund të trajtohen me dëmshpërblim, por që sipas këtij dikasteri duhet të sjellin dokumentet e nevojshme. Bëhet fjalë për listën e kategorisë jo parësore, për trashëgimtarët, rreth 3000 përfitues, të cilët do të marrin dëmshpërblim, por më parë duhet të plotësojnë dosjet me dokumente. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë, së bashku me analizën e dokumentacionit për çdo dosje, si për përfituesit e kështit të parë, ashtu edhe për ata të kështit të dytë. Dokumentet për trajtimin me dëmshpërblim pas shqyrtimit të juristit, duhet të dorëzohen brenda tre muajve.

DOKUMENTET

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shumica e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi

ndryshim të identitetit, Emër/Mbiemër, apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një gërmë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha dokumentet emrat të jenë të njëjtë me atë

që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në raste se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe

rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq, është i domosdoshëm një vendim fakti gjykatë që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të periudhës përkatëse dhe ky fakt

vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", - thuhet në njoftimin që Ministria e Financave bën për të sqaruar trashëgimtarët e ish-të dënuarve që nuk kanë marrë ende dëmshpërblimin.

TRASHËGIMTARËT PËR KËSTIN E PARË

SHENIM: Tër dokumentacioni është i rregullt shënohet me V, kur mungon shënohet me X, kur kanë autorizuar me prokurë shënohet me P.

NR. DOSJES	EMER	MBIEMER	VKM.NR.	EMER	ATESIA	MBIEMER	EMER	ATESIA	MBIEMER	KOPE TE LETER NJOFITIM	NUMER PERSONAL LLOGARIBANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE TRINGUT FAMILJAR	DESIMI TRASHGIMIE	PROKURE
1066	AHMET	XHANI		HATIXHE SELIM	REZA XHANI							V	V	V	
				AHMET XHANI								X	X	V	
					ARTAN SELIM	XHANI				X	X				P
					ELIR	XHANI				X	X				V
					ELIRABITA	XHANI				X	X				P
					KRESHNI K.	XHANI				X	X				P
				ISMET	AHMET XHANI					V	V				P
				HALIME	AHMET AGALLIU					X	X				V
				DHIMO	AHMET XHANI					V	V				P
1560	ASLLAN	TAGANI		DHURAT A	RESHIT ASLLAN							V	V	V	
					LEGATA GANI					V	V				
4542	ILAVILLI	QENDRI										V	V	V	
				CALO	ILIJ QENDRI							V	V	X	
				STEFAN	ILIJ QENDRI							V	V		
				VASILE	ILIJ CABIRI							V	V	V	
				NIKO	ILIJ QENDRI							V	X	V	
					ANDREA NIKO	QENDRI				V	V				
11170	HELMI	HOXHA		RAGIP	HOXHA							V	V	V	
				HAVA	MALIQ HOXHA							V			P
				RAGIP	HELMI HOXHA							V	V	V	
				AGRON	HELMI HOXHA							V			P
				GENCL	HELMI HOXHA							V			P
1194	MUHAMET	SKENDE RAS		EDMOND FERIT	SALI SKENDE RAS							V	V	V	
					MUHAMET SKENDE RAS							V	V		
1166	QAMIL	TAFARU CI		ELTON	QAMIL TAFARU CI							V	X	V	
					ELTON QAMIL	TAFARU CI				V	V				
11276	MARK	HUBA		PRENG DODE	GJOK MARK HUBA							V	V	V	
					MARK HUBA							V	V	V	
					LULE DODE	LLESHI HUBA				V					P
					PRENG DODE	HUBA				V					P
					NIKOL DODE	HUBA				V					P
					PAL DODE	HUBA				V					P
					NDREC MARK HUBA					V	V	V			
					SHAQ	NDREC GJERGJI HUBA				V					P
					PRENG SIBON	NDREC HUBA				V					P
					PIETER	NDREC PERNDRECAJ HUBA				V					P
					GJERGJ MARK HUBA					V	V	V			
					MARTIN GJERGJI	HUBA				V					P
					VALENTIN GJERGJI	HUBA				V	V				V
					DRANDE TUNE	MARK LLESHI GJERGJI				V	V				
					MARK LLESHI GJERGJI					V	V				
1428	ADEM	GAVANE		GJYSLY ME NIAZI YLBER	SELFO GAVANE							X	V	V	
					ADEM GAVANE							V			
					ADEM GAVANE							X	X	V	
					ADEM GAVANE							X	X	V	
					LORENC HERIDON FRONA	YLBER GAVANE				X					P
					FRONA YLBER	SHIHU				V	V				
				FATIR DHA GJON	ADEM MURATI	GAVANE				V	V			X	
1418	NESHIM	SHURDHA		LEFTON	TEFIK NESHIM SHURDHA							V	V	V	
					NESHIM SHURDHA					X	V				
1965	HASAN	KASMI		MUSTAFA	MUSTAFA KASMI							V	V	V	
				IBRAHIM	MUSTAFA KASMI							V	V	V	
					RAMAZAN	IBRAHIM KASMI				V	V				V
					VASKI	IBRAHIM KARAJ				V	V				P

SHENIM: Tër dokumentacioni është i rregullt shënohet me V, kur mungon shënohet me X, kur kanë autorizuar me prokurë shënohet me P.

NR. DOSJES	EMER	MBIEMER	VKM.NR.	EMER	ATESIA	MBIEMER	EMER	ATESIA	MBIEMER	KOPE TE LETER NJOFITIM	NUMER PERSONAL LLOGARIBANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE TRINGUT FAMILJAR	DESIMI TRASHGIMIE	PROKURE
1447	SHEFIT	ZENUNA J		QERIME	SABRI	ZENUNA						X	V	V	
				QERIME	SABRI	ZENUNA						X	V	V	
				HYSENI	SHEFIT	ZENUNA				V	V				V
				RAMADAN	SHEFIT	ZENUNA				V	V				P
				DALLAN DYSHE	SHEFIT	ZENELAJ				V					P
				SOFIE	SHEFIT	HOXHA				V					P
				BLANKO	SHEFIT	STANI				V					P
				VERA	SHEFIT	KAPAJ				V					P
10119	SULEJMAN	ZENELI OXHA		QEMAL	SULEJMAN	ZENELI OXHA						X			P
				SALI	SULEJMAN	ZENELI OXHA				X					P
				LEONARD	SULEJMAN	ZENELI OXHA				X					P
				DURIM	SULEJMAN	ZENELI OXHA				V	V				V
				XHEMILE	SULEJMAN	GORO				X					P
15165	NDUE	GJIKOLA		MRIKA	GJIKOLA							X			P
				BARIMO	NDUE	GJIKOLA				X					P
				GJETE	NDUE	GJIKOLA				X					P
				DAYA	NDUE	SHIPANI				X					P
				KRISTINA	NDUE	PERLKA				X					P
				GOVALLI	NDUE	GJIKOLA				V	V				V
				MIMOZA	NDUE	NIKOLLI				X					P
				FLORINDA	NDUE	GJIKOLA				X					P
6796	MEHMET	MUHADR I		HATE	BAHRAM	MUHADR I MUHADR I						X	V	V	
				SOKOL	MEHMET	MUHADR I MUHADR I				X	V	V	V		
										X	X	V			
					SHIPEND MAJLINDA	SOKOL MUHADR I XHAMO				X	V				
				SHIPRESA	MEHMET	GALLA				X	X	V			
					FADIL	ISA GALLA				X	V				
					ELVIRA	ISA KAMRISI				X	X				
					THUTA	ISA GRIZAJ				X	V				
					NAXHIE PETRIT	MEHMET GALLA				X	V				
					HALIM	SALA				X	V				
1440	STEFAN	POLO		ATHENA KOSTA	STEFAN KOSTA	KOLLA POLO						X			P
					STEFAN KOSTA	KOLLA POLO				X					P
					AGRON	CELI				V	X				P
1830	XHEMAL	BAIRAKTARI		DVLBER BRINDA	XHEMAL MALE	BAIRAKTARI						X	X	V	
				BEATRICE	XHEMAL	BAIRAKTARI				X	X				
				BRITAN	XHEMAL	BAIRAKTARI				V	V				
				AMARILDO	XHEMAL	BAIRAKTARI				X	X				
1850	SOFO	NARE		MAQUM ABU	SOFO	THANAS NARE (OCDA)						X	X	V	
						MARIKA				X	V				V
						SOFA				X	V				V
						VANGHEL				X	V				V

KONFERENCA

“Hiqet kryetari Beqiraj”, Akademia luftë kundër shkrirjes, i shtrin dorën Ramës

Fatmira Nikolli

Asambleja, shkresë Metës për arsyet e mosdekretimit, gati reforma

Drejtimi i Akademisë i hiqet kryetarit, i kalon Asamblesë

Akademia e Shkencave po lufton fort për mbijetesë, edhe pse është në grahamat e fundit. Pas kërcënimit të Ramës në fillim të shtatorit se “nëse zgjedhjet do të ishin farsë, do hiqej buxheti”, në tetor, në media qarkulloi lajmi se kryeministri fondet e dedikuara për Akademinë ia ka kaluar Ministrisë së Arsimit për kërkimin shkencor, duke e lënë atë pa buxhet, çka çon në zhdukje të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Edhe pse një vendim i tillë nga ana procedurale është nonsens, sepse Akademia funksionon në bazë të një ligji që mund të ndryshohet vetëm nga parlamenti, duket se kreu i qeverisë e ka seriozisht. Debatimi pati nisur me akuzat e akademikut Artan Fuga, që i cilësoi farsë zgjedhjet për kryesinë e ASH-së, meqë u rikthye si kryetar, ish-kryetari Gudar Beqiraj.

Dy muaj më vonë, pas kësaj zgjedhjes live në media, pa pasur asnjë kandidat përballë, Gudar Beqiraj është i padekretuar nga Presidenti i Republikës dhe pa të drejtë firme, çka ka bllokuar edhe reformën, së cilës duhej t'i nënshtrohej Akademia.

PAQE ME RAMËN, “HIQET” BEQIRAJ

Sekretari shkencor i Akademisë së Shkencave, Vasil Tole tha dje në një konferencë para mediave se akademikët e ftojnë Ramën në debat konstruktiv. Ai bëri me dije se “në këtë situatë jo të zakonshme mbështetur ligjit, drejtimi i Akademisë së Shkencave ka kaluar në dorë të Asamblesë së Akademisë, e cila përfaqëson bashkësinë tonë akademike, që është organi më i lartë i punës së saj, që krahas të tjerash shqyrton edhe problemin perspektiv të shkencave në vend dhe u paraqit propozime organeve kompetente”. Në mbledhjen e saj të fundit, Asambleja vendosi ndërmarrjen e disa veprimëve, ndër to edhe ky komunikim për median, që përbehet nga paneli akademikë Aurel Anastasi, Salvator Bushati, Apolon Baçe, Artan Fuga, Beqir Meta dhe Vasil Tole. Tole tha se në vijim të dialogut me kryeministrin Edi Rama, asambleja i është drejtuar me një ftesë zyrtare për takim për zhvillimin e një debati konstruktiv, si një lloj modeli bashkëqeverisjeje me sh-



Konferenca

kencëtarët në këtë fazë përmblyllesë të reformës. “Asambleja vendosi që të sqarojë çështjen e mbetur pezull në lidhje me

emërimin nga Presidenti, të kryetarit të zgjedhur të saj. Për këtë i është drejtuar së fundmi me një kërkesë konform legjislacionit për in-

formimin për t'u shprehur në lidhje me këtë praktikë të dërguar”, tha Tole.

Akademia e Shkencave ka vendosur t'i kërkojë Min-

istrisë së Arsimit raftet e strategjisë kombëtare të teknologjisë dhe inovacionit për vitet 2017-2022, dokumentin për politikën e re-

formimit të këshillit kombëtar të këshillit shkencor, edhe projektligjin e ri për shkencën, të cilat nuk i ka pasur asnjëherë.

Tole tha se pranë Akademisë së Shkencave është ngritur komisioni i përbërë nga akademikë nga gjithëhapësira mbarëkombëtare shqiptare, me përfaqësues të Akademisë sonë, të Kosovës, Maqedonisë, botës arbëreshe edhe diasporës, që brenda një afati 2-javor do të përgatisin propozimin kolegjial për reformën e kërkimit shkencor edhe vendin e ASH-së.

“Shpesh, Akademia ngatërrohet me problemet e veta, që ne jemi të ndërgjegjshëm që ka vend për reformim, me Akademinë si trashëgimi, që është krijuar ndër vite, falë përpjekjes së akademikëve ndër vite. Këtë mesa duket ka pasur parasysh edhe vetë shkrytari Dritëro Agolli, i cili u shpreh para disa vitesh, duke thënë se: ‘Akademia e Shkencave është institucione që duhet të forcohet edhe jo të dobësohet’. Akademia e Shkencave ka pasur përherë

Reformë kundër shkrirjes, debat mes akademikëve



Artan Fuga

A mund të ndryshohet statuti dhe rreziku për Beqirajin

“ka një situatë të njerëzve që duan të bëjnë debat edhe të mos nxjerrin asgjë nga kjo punë, ndërkohë që ne jemi këtu me vullnetin e shumicës së akademikëve për të bërë debat

dhe për të gjetur zgjidhje. Në këtë hulli jemi, edhe zgjedhja është vetëm ajo që thamë, në shtetin e së drejtës. Ne së pari mundësojmë dialogun, së dyti, t'i afrohem zgjedhjes së

gjithëpranuar pa kufizuar alternativat e kolegëve”.

Tole shtoi se “çështja e zgjedhjes së kryetarit të Akademisë së Shkencave, në rastin tonë nuk është me emërim, por është me zgjedhje. Të gjithë anëtarët e Akademisë, mbështetur në një proces që ishte tërësisht i hapur, mund të kandidonin për këto pozicione. Alternativat e kandidatit mund të mos jenë të shumta, por sigurisht gjejmë një arsye që mund ta vëmë në zbatim të statutit të Akademisë, që të mos pranojmë më zgjedhje për kryetar të akademisë pa kandidaturë alternative. Natyrisht që do të diskutojmë për këtë çështje, sepse jemi në një proces edhe për reformimin e statutit, në lidhje të ngushtë me të gjithë reformën e kërkimit shkencor, por do të shikojmë të gjitha mundësitë”.

FONDET

Tole tha se akademikët nuk tremben nëse do t'i përfitojë Akademia ato buxhete, apo ato përfitime modeste që ka. Ndërsa Fuga shtoi se, “pa këto fonde, që janë minimale po t'i krahasosh, Akademia e ka të vështirë që të funksionojë, pasi nuk funksionon dot as pa strukturat administrative, nuk funksionon dot as pa pasur mbështetje financiare për shërbimet minimale që kryen, por problemi nuk është thjesht i akademikëve, por i modelit të institucioneve publike në Shqipëri, i statusit institucional të shkencëtarëve në Shqipëri dhe e treta, e politikave se si menaxhohet shkenca edhe kërkimi shkencor në Shqipëri. Kjo do të thotë që në qoftë se kjo Akademi nuk i ka këto fonde, është e pamundur që ajo të funksionojë, pavarësisht se atë që akademikët përfitojnë si shtesë në pagën e tyre, siç e përfitojnë qindra profesorë të asociuar edhe dhjetëra e qindra doktorë në Shqipëri, edhe me këtë Ak-



njerëz të zotë, edhe u themelua nga dijetarë me emër. Edhe ASH nuk është thjesht një çështje qeveritare, por kombëtare”, shtoi Vaso Tole. **KRYETARI I PADEKRE-TUAR**

Akademikja Aurela Anastasi tha se asambleja e ASHSH-së të Shqipërisë mbështet plotësisht reformën e kërkimit shkencor edhe vazhdon që të jetë e angazhuar në këtë proces, si edhe në reformimin e vetë ASH-së, me synimin kryesor fuqizimin e saj. “Asambleja e Akademisë së Shkencave në kuadrin e procesit të reformimit do të miratojë në 16 nëntor projektpropozimin e saj për reformën e ASH-së, që do t’i dërgohet

Këshillit të Ministrave dhe do të bëhet i njohur publikisht”. E pyetur nga mediat për mosdekremin e kryetarit të Akademisë së Shkencave nga Presidencia, Anastasi tha se, “nuk ka një përgjigje. Kryetari është zgjedhur në 4 shtator, ndër-asambleja në takimin e 31 tetorit i kërkon presidenti një përgjigje në bazë të kësaj. Presidenti i Republikës në bazë të Kushtetutës duhet që të dekretojë, me qëllim që të legjitimohet dhe kushtetohet zgjedhja e asamblesë së Akademisë së Shkencave. Nëse nuk dekretohet, do të thotë që ajo mbetet nul”. Sipas saj, natyrisht që presidenti nuk është i detyruar ta dekretojë, “por ne mendojmë se duhet që të na japë disa arsye, në qoftë

Çdo gjë do të argumentohet. Në vazhde të kësaj çështjeje, Vasil Tole shtoi se, “ne si institucion jemi bashkëpunues. Do të synojmë që propozimi që do të jetë në emër të ASH-së të jetë sa më i gjithëpranuar, i cili sido që të jetë, do të votohet dhe nuk do të shuajë nuancat e ndryshme të kolegëve”.

SEBEPI SI ZGJIDHJE

Sebepi i debatit të madh që përfshiu Akademinë e Shkencave ishte Artan Fuga, duke qenë se ngriti akuzat mbi zgjedhjet dhe gjendjen. Dy muaj më vonë, ai është rikthyer në Akademi - tanimë përkrah kolegëve, duke kërkuar zgjidhje. “Unë jam për Akademinë që të funksionojë si një forum i pavarur i komunitetit të shkencëtarëve edhe i

ademia nuk funksionon dot, sepse kërkon një buxhet funksionimi”.

Fuga shtoi se, “humbja nëse ndodh, nuk është jona si anëtarë të asamblesë së Akademisë, nuk kemi ne asnjë konflikt interesi, por problemi është i komunitetit të shkencëtarëve. Thirrja ime është për tërë komunitetin e shkencëtarëve, që edhe nëse flukset hyrëse në Akademi nuk kanë qenë si duhet, kjo nuk do të thotë që ky status i akademikëve të prishet, por këtu ka nevojë për t’u ndrequr. Këtu është problemi se çfarë statusi do të ketë në shoqërinë shqiptare shkenca dhe kërkimi shkencor, në një shoqëri që quhet shoqëria e kërkimit e shkencës dhe e dijes. Si mundet ne që të bëjmë një hap mbrrapa, që komunitetit të shkencëtarëve t’u heqin statusin e tyre publik të njohur me ligj, duke e zëvendësuar me një OJF”.



Gudar Beqiraj

se vendos të mos dekretojë në krye të asamblesë kryetarin e Akademisë së Shkencave. Kushtetuta nuk ka një afat për këto lloj dekretesh, por ne mbështetemi vetëm në afate të arsyeshme”.

REFORMA

Të pyetur nëse akademikët kanë rënë dakord për reformën në Akademinë e Shkencave, Apollon Baçe tha se asambleja vendosi që në datë 16 do të jetë përgjigja për reformimin. Nuk do të jetë një opsion, por do të jenë të gjitha opsionet e mundshme, duke argumentuar se cilat janë anët pozitive, negative edhe sesa kushtojnë.

kërkuesve shkencorë në Shqipëri, por si një institucion i pavarur partner i qeverisë, edhe i institucioneve publike apo private të Shqipërisë. Por i pavarur, siç është në ligj tani”, tha ai. Ai konfirmoi se prej dhjetë ditësh janë në kohërencë edhe në konvergencë të mendimeve të tyre. “Është bërë një hap shumë pozitiv, që asambleja ka vendosur që të gjitha modellet e propozuara të diskutohen, ballafaqohen edhe të marrin vendimin dhe aprovimin e asamblesë edhe t’u paraqiten instancave përkatëse që merren me këtë punë”.

EKSPOZITA

“Vox-machina”, Sadik Spahija kthen në art mbetjet industriale


Edi Muka: Të rikuperosh ato që u destinuan të harrohen

‘Vox-machina’ e Sadik Spahisë, nën kurimin e Edi Mukës, është ekspozitacion sonor me performancë nga trupa e baletit, që fokusohet në trashëgiminë materiale, konkretisht të rrënojave dhe mbetjeve industriale të fabrikave të mbyllura të para vitit 1990. Ekspozita e mbështetur nga Ministria e Kulturës u hap në 1 nëntor 2017 në mjediset e pambaruara të Skenës së Re - Turbina. Këto mbetje industriale të konsideruara nga artistit si produkt shoqëror me një kosto dhe tashmë si një dilemë ndërmjet asgjësimit dhe transformimit.

pothuajse në të gjithë Shqipërinë, objekte të regjistruara në kontrata dhe në biseda të pafundme me njerëzit, për të kuptuar se si ata reagojnë karshi këtyre objekteve edhe materialeve. Edhe vetë kur jam marrë me këtë projekt kam kuptuar se brenda tyre është dendësuar një punë e pafundme, një djersë e bërë nga prindërit tanë dhe më përpara”, ka thënë artistit.

Kuratori Edi Muka tha se Spahija i rikuperon objektet e dënuara me harresë dhe zhdukje për të ndërtuar një refleksim mbi atë çka ato

timeve të ideologjive të vjetra e të reja, që kontrollojnë dhe kontrollojnë destinon tonë nga e shkuara komuniste në të tashmen globale të mjegullt e pa trajta, drejt një të ardhmeje të panjohur, ku muzgu i njerëzimit mund të shndërrohet në agimin e makinës. Turbina ka nisur “jetën artistike” akoma në ndërtim e sipër. Enisi me ‘Mediterranea 18 - Young Artists’ Biennale, ku artistët shqiptarë e ndërkombëtarë u dashuruan me format e vëllimet e skenës së Turbinës, vazhdoi me forumin Forum Re-



Projekti është konceptuar si një bashkëveprim i shumë faktorëve njerëzorë, ku integrohen jo vetëm eksperiencat profesionale, por edhe përvoja njerëzore të mbartura në këto mbetje industriale. Gjatë ekspozimit, kompozitori Hajg Zaharjan ka krijuar një pjesë instrumentale në krijimin e tingujve organikë që përkrijnë me iluzionin vizual të instrumenteve muzikore monumentale, të krijuar nga relikat industriale.

“Është një punë e gjatë kërkimore edhe eksperimentale, për të sjellë afër publikut një kumt, që shqetëson shoqërojnë shqiptarë sot, për ta sjellë në formë alternative, e cila nuk jep përgjigje por shtrun pyetje. Shtron pyetje, që ne ia bëjmë përditë vetvetes, që gjejnë përgjigje, por përgjigjet tona janë afatshkurtra. Ideja e kësaj ekspozite është pikërisht që përpjekja dhe munda ynë

përfaqësojnë dhe çka mund të na mësojnë. “Ai ndërhyr në to duke i shtuar pjesëza qeramike, të cilat si për nga materiali i tyre (baltë e pjekur) ashtu edhe nga forma e zgjedhur i japin makinerive trajta të reja me gjymtyrë të kalçifikuara të këtyre genieve të çuditshme, që duket sikur janë zbuluar nga gërmimet e një epoke që shtrihet diku përtej, në një mugetirë ku e shkuara përzihet me të ardhmen e largët. I yshtur nga një kuriozitet i tij, për t’i parë ato si instrumente muzikore mbartëse të një ideologjie, Spahija kalon nga akti i rikuperimit në një akt shndërrimi”, tha Muka. Shtoi mandej se ‘Vox Machina’ e Sadik Spahisë na zhvendos në kohë përmes prem-

birth Tirana/Love Difference - i Mediterranean në idenë e Cittadellarte-Fondazione Pistoletto dhe tani ky kantier hyn në një bashkëjetesë artistike me një koncept nga artisti Sadik Spahija titulluar “Vox Machine”. Ekspozita “Vox Machine”, që është ideuar për këtë skenë nga artistit Sadik Spahija, kuruar nga Edi Muka në bashkëpunim me artistët të imazhit, lëvizjes, tingullit: Gjergj Prevazi, Hajg Zaharjan, Endri Sina, Ramazan Gurra, Akreoma Saliu, Robert Nuxha, Fjoraldo Doci, Rosella Pellicciotti, Melissa Becovic. Qëndron e hapur nga data 1-10 nëntor 2017.

Opinion i Ditës

Marks, Hygo, Puigdemont... mërgimtarë në Bruksel

Nga Jorgji Kote

(vijon nga faqja 1)

... siç e konfirmoi vetë në konferencën e shtypit, por për "exil", pra mërgim në kryeqytetin e Evropës së Bashkuar. Për shkak sipas tij, të pasigurisë për një proces të drejtë dhe të ndershëm gjyqësor të hapur ndaj tij për rebelim. Miqtë e vet nacionalistë flamandë e kanë mirëpritur. Kurse politika belge është qetësuar, pasi kërkesa për azil politik edhe pse juridikisht e mundshme, politikisht do të tensiononte marrëdhëniet Belgjikë-Spanjë. Nuk po zgjatemi në këtë çështje, sepse disa ditë më parë kam shkruar po në këtë gazetë "Katalonja Spanjolle si Flandra Belge".

Natyrishit që tërhoqi vëmendjen masive publike fakti që Brukseli pranon mërgimtarë të tillë "VIP" të kërkuar nga drejtësia e një vendi anëtar të BE-së. Kjo shpjegohet edhe ligjërisht me historinë 186-vjeçare të këtij shteti, madje autoritetet belge dhe të Brukselit në veçanti kanë krijuar të gjitha lehtësitë e nevojshme, natyrishit kundrejt disa kushteve kufizuese lidhur me aktivitetin politik për të gjithë ata persona, sidomos ata VIP dhe pa kurrfarë dallimi për të cilët ka gjasa, prova apo dyshime të arsyeshme se mund të ndiqen, persekutohen apo dënohen padrejtësisht në vendet e tyre për motive politike, fetare, gjinore etj.

Mjafton t'u hedhësh një sy kalimthi disa prej shembujve më pikantë që tregohen dhe më poshtë kur Brukseli është bërë vend i preferuar për azil/egzil për shumë personaliteteve të spikatura politike, artistike e kulturore, që kanë ndryshuar dhe tronditur botën me veprat dhe krijimet e tyre dhe bindesh lehtë për këtë realitet.

Kështu, në vitin 1848-1849, Karl Marks, në atë kohë 30-vjeçar kërkoi azil në Bruksel. Autoritet mbretërore belge e lejuan me kusht që të mos merrej me politikë. Ai ka banuar në 4-5 adresa të ndryshme në Bruksel, por selia kryesore e veprimtarisë së tij ishte në Grand Place, në restorantin e mirënjohur historik "La Maison du Cygne" (Shtëpia e Mjellmave). Aty, Marks zhvillonte takimet e famshme dhe fliste me pasion përpara simpatizantëve të majtë dhe komunistë, mes tymit të duhanit dhe avullit të pijeve. Padyshim që gjendja e rëndësishme social-ekonomike e shumicës dërmuese të popullsisë atje i dha "lëndën e parë" për veprat e tij me ndikimin tashmë të njohur për botën. Ndoshta pak e dinë se pikërisht aty, në "Grand Place", në sheshin më të bukur karakteristike evropian dhe në "La Maison du Cygne", Marks shkroi "Manifestin Komunist", çka tregoi edhe në pllakat përkujtimore në atë godinë, ngjitur me bashkinë



e kryeqytetit belg. Bashkë me të qëndroi në Bruksel edhe "klasiku" tjetër i shquar, Friedrich Engelsi.

Po gjatë asaj periudhe e më vonë, Brukseli liberal u bë edhe qendër e hapur pritjeje për shumë shkrimtarë, poetë dhe piktorë të famshëm nga Franca, Britania e Madhe, vende të tjera dhe Shqipëria jonë. Bëhet fjalë për emra tingëllyes si Dumas, Rimbaud, Baudelaire, Rodin, Sir Walter Scott, Lord Byron, etj.

Aty, në "Brukselin e mrekullueshëm" siç e ka përshkruar vetë, jetoi gjatë viteve 1851-1852, 1861-1862 dhe 1866-1870 në azil të vërtetë politik gjiganti francez i letrave botërore, Viktor Hygo me familjen. Aty ai "gdhendi" një nga kryeveprat e tij, "Të Mjerët" etj.

Kështu, në vitin 1848-1849, Karl Marks, në atë kohë 30-vjeçar kërkoi azil në Bruksel. Autoritet mbretërore belge e lejuan me kusht që të mos merrej me politikë. Ai ka banuar në 4-5 adresa të ndryshme në Bruksel, por selia kryesore e veprimtarisë së tij ishte në Grand Place, në restorantin e mirënjohur historik "La Maison du Cygne" (Shtëpia e Mjellmave). Aty, Marks zhvillonte takimet e famshme dhe fliste me pasion përpara simpatizantëve të majtë dhe komunistë, mes tymit të duhanit dhe avullit të pijeve.

Shoqata Kulturore "Konica" me aktivitete të shumta, publicisti i njohur shqiptaro-belg, Safet Kryemadhi dhe gazetari i përkushtuar Gjovalin Kola kanë kontribuar shumë me botimet e tyre cilësore për njohjen dhe përhapjen e veprimtarisë publicistike dhe atdhetare të Faik Konicës, si dhe të Enver Hadrit e patriotëve të tjerë në rrethet politike, mediatike dhe publikun belg.

Diçka më vonë, gjatë periudhës 1897-1909 banoi në Bruksel edhe personaliteti i ndritur i letrave shqipe, Faik Konica, ku botoi "Albania" e tij të famshme në shqip dhe frëngjisht. Ai ka jetuar në

"Rue d'Albanie" 23, komuna Saint Gilles, diku në qendër të Brukselit.

Për koïncidencë, në vitet '80, në po atë banesë u vendos mërgimtari politik i Kosovës martire, Enver Hadri, i cili luajti një rol të madh për njohjen e çështjes së saj, të shtypjes e persekutimit nga regjimi serb. Enverin e vrau dora armiqësore serbe më 25 shkurt 1990, kur po shkonte në një takim pune kushtuar Kosovës. "Rue d'Albanie" me dy pllakat përkujtimore është tashmë një pikë pelegrinazhi mikpritëse, venë për nderuar edhe familjen e heroit.

Shoqata Kulturore "Konica" me aktivitete të shumta, publicisti i njohur shqiptaro-belg, Safet Kryemadhi dhe gazetari i përkushtuar Gjovalin Kola kanë kontribuar shumë me botimet e tyre cilësore për njohjen dhe përhapjen e veprimtarisë publicistike dhe atdhetare të Faik Konicës, si dhe të

Enver Hadrit e patriotëve të tjerë në rrethet politike, mediatike dhe publikun belg.

Në fillim të shekullit XX, Brukseli u bë sërish bujtës tashmë i qendrave dhe lëvizjeve opozitare, që ishin të pamundura në vendet e tyre. Aty kishte selinë e vet edhe Sekretariati i Internacionales Socialiste, ku edhe bolshevikët e Leninit kanë zhvilluar disa mbledhje. Madje, ka të dhëna se edhe Lenini ka qenë në qytetin e Liezhit dhe në Bruksel gjatë muajve tetor-nëntor 1909.

Dihet gjithashtu se në mesin e viteve '30 erdhi dhe punoi nga Franca në Bruksel, si punonjës i Konsullatës shqiptare edhe Enver Hoxha.

Gjatë Luftës së II Botërore kjo traditë u ndërpre, sepse qeveria belge u detyrua të shkonte vetë në mërgim në Londër, pas pushtimit nga Gjermania naziste. Por, pas përfundimit të luftës, Brukseli e rifilloi traditën e tij, madje këtë radhë në përmasa shumë më të mëdha. Ndoshta kjo mikpritje e konsideruar si vlerë e shtuar ka qenë edhe një ndër arsye të shtesë që çoi në përzgjedhjen e Brukselit si selia e BE-së, NATO-s dhe shumë organizatave të tjera ndërkombëtare.

Me kalimin e viteve dhe dekadave, Brukseli dhe e gjithë Belgjika u bënë bujtës dhe strehues bujarë të mijëra azilantëve politikë dhe emigrantëve ekonomikë nga 170 vende të tjera, përfshirë edhe Shqipërinë, duke filluar nga viti 1956 e në vazhdim, sërish pa asnjë dallim partiak dhe ideologjik.

Falë mbështetjes dhe ndihmës së gjithanshme të shtetit belg, shumë prej azilantëve të dikurshëm tashmë janë bërë figura të shquara politike, të artit dhe kulturës belge e më gjerë. Vlen të përmendet lideri socialist dhe ish-kryeministri belg, Elio Di Rupo, bir i një emigranti italian si dhe shkrimtarë dhe artistë të shquar.

Ndërkohë, tradita e azilit/egzilit për personalitetet politike vijoi në vitin 2011, kur erdhi në Bruksel pas përndjekjes dhe persekutimit në vendin e vet Etienne Tshisekeda, kryepozitari i famshëm kongolez, rivali dhe kundërshtari i despotëve famëkeq Mugabe dhe Kabilat, baba e bir; ai ndërroi jetë në moshën 84-vjeçare më 1 shkurt të këtij viti gjatë një trajtimi mjekësor po në Bruksel.

Kësisoj, Carle Puigdemont është mërgimtari politik i radhës në Bruksel, por me siguri jo i fundit. Mbaje gjatë këtyre ditëve, ai do të mësojë më shumë nga fryma e vërtetë e Evropës së Bashkuar, nga homologët e tij flamandë dhe për rrjedhojë, edhe përmasat e gabimit të tij fatal politik, me krijimin e Republikës së Pavarur të Katalonjës; kjo e fundit "vdiq ende pa lindur", sepse ishte jashtë kohe, pa baza dhe pa politika. Vetëm se ndryshe nga të tjerët, mërgimi i tij në Bruksel ka shumë të ngjarë të jetë fare i shkurtër, pasi drejtësia spanjolle po bën gatë mandat-arrestin ndërkombëtar.

Dje në "Deutsche Welle"

Jeta e rrezikshme e gazetarit

Të rrëmbyer, të torturuar, të vvarë në të gjithë botën, dhuna kundër gazetarëve është shtuar. Por vetëm një në dhjetë krime sqarohet. Armiqtë më të mëdhenj të gazetarëve shpesh janë shtetet ku punojnë gazetarët.

Nga Julia Vergin

(vijon nga faqja 1)

... of Expression and Media Development". Në bazë të rrjetit "Reporterë pa kufi", në vitin 2017 kësaj shifre iu shtuan edhe 47 gazetarë të tjerë. Krahasuar me dekadat e mëparshme kemi një rritje të dukshme, "Jeta si gazetar po bëhet më e rrezikshme", konfirmon Christian Mihr, drejtor ekzekutiv i "Reporterëve pa kufi". Dhe vetëm një ndër dhjetë krime sqarohen. Për të tërhequr vëmendjen në këtë gjendje të rëndë, në vitin 2013 OKB-ja shpalli "Ditën ndërkombëtare kundër mosdënimit të krimeve kundër gazetarëve".

Veçanërisht të rrezikuar janë qytetarët që punojnë si gazetarë, të ashtuquajturit gazetarë qytetarë, të cilët përhapin informacione në mediet sociale si në "Facebook" dhe në "Twitter". Ata raportojnë nga rajone dhe vende, në të cilat nuk guxojnë të shkojnë me gazetarët klasikë. Në një rezolutë të OKB-së të vitit 2014 pranohet për herë të parë roli dhe nevoja për mbrojtje e gazetarëve qytetarë. Por, me gjithë rezolutat e shumta, të cilat duhet të garantojnë mbrojtjen e atyre që informojnë, numri i vrasjeve është i lartë.

TË DREJTAT E NJERIUT? JO DHE KAQ TË RËNDËSISHME

Shkak për këtë sipas Mihrit janë dukuritë e shpërbërjes në shumë shteteve. "Në Afganistan, në Siri ose në Somali faktikisht pushtetin e kanë organizata, të cilat nuk ndihen të lidhura me marrëveshjet e miratuara të të drejtave të njeriut", thotë Mihr.

"Por, shpërbërja e shteteve nuk është problemi më i madh - thotë Mihr. - Në shumë raste shtetet vetë nuk janë fare të interesuara për sqarimin e një krimi. Gazetarët shpesh raportojnë për gjëra, të cilat nuk u pëlqejnë anëtarëve të



caktuar të qeverisë ose të administratës". Për të gjetur një sjellje të tillë nuk duhet të shkosh shumë larg, mjafton të shkosh deri në Maltë. Mihr dyshon që ekziston një interes i ndershëm shtetëror në hetimet për vrasjen e gazetares Daphne Caruana Galizia.

RRËMBIME, ARRESTIME DHE TORTURA

Jo vetëm numri i gazetarëve të vvarë është në rritje, në rritje është edhe numri i akteve të dhunshme. Arrestime arbitrare, rrëmbime dhe tortura janë vetëm disa nga krimet që numëron OKB-ja.

Kësaj i shtohet dhuna në hapësirën digjitale përmes fushatave të nxitjes dhe sulmeve ndaj faqeve të internetit të gazetarëve jo të preferuar. Shumë ndiqen hap pas hapi me anë të përgjimit digjital. Ajo që tingëllon e padëmshme përfundon jo rrallë në dhunë reale. "Në gjysmën e të gjitha rasteve, në të cilat "Reporterët pa kufi" japin ndihmë emergjente, njerëzit ndodhen në një situatë emergjente, pra janë arrestuar ose po torturohen, sepse janë përgjuar me parë në mënyrë digjitale", thotë Mihr.

Prandaj "Reporterët pa kufi"

kërkojnë një të ngarkuar të posaçëm të OKB-së, sipas shembullit të "Të Ngarkuarit të Posaçëm për Fëmijë dhe Konflikte të Armatosura", të cilin e ka emëruar në vitin 1997 OKB-ja. "Ky i Ngarkuar i Posaçëm mund të bënte kërkime në mënyrë të pavarur dhe të dokumentonte rastet e dhunës ndaj gazetarëve, në mënyrë që këto raste të ndiqen penalisht", thotë Mihr. Kjo ide ka shumë mbështetës, Bundestagu gjerman është parlament i parë në botë që e ka kërkuar këtë vit të Ngarkuarin e Posaçëm.



HOROSKOPI

DASHI

Mjafton të mësoni të vëzhgoni, do të zbuloni se jeta çdo ditë mund t'ju dhurojë ato gjërat e vogla të bukura, që mund të bëjnë të lumtur cilindo prej nesh. Bëni kujdes nga lodhja nervore, jeni shumë të ndjeshëm dhe përfshihen shpejt në gjendjen emocionale të të tjerëve.

DEMI

Marsi nuk do të jetë shumë i favorshëm sot dhe kështu do t'ju duket se ata që ju qëndrojnë pranë, mund t'ju kundërshtojnë. Kërkoni një bisedë sqaruese. Ndërsa jeni nën ndikimin e Marsit, mos e merrni çdo gjë për të mirëqenë.

BINJAKET

Hëna do të bashkëveprojë ndjeshëm me planetë të ndryshme. Disa paqartësi në fillim të ditës, por më vonë gjithçka do të sqarohet në mënyrë më të mirë. Përdorini mënyra, të cilat ju përshtrihen më shumë: mirësjellje, takt, mirësi, dashamirësi.

GAFORJA

Nganjëherë jeni shumë të shpejtuar dhe drastikë. Bëni mirë të merrni parasysh këtë gjë, sepse ndodh që persona rreth jush të shqetësohen. Vazhdoni të angazhoheni për punët profesionale, por lejoni vetes edhe pak kohë të lirë dhe shijoni emocione të ndryshme nga e zakonshma.

LUANI

Pas ditësh të mbushura me angazhime, po vijmë momente më të qeta. Do të ndiheni në formë, të qetë dhe në dispozicion të personit që ju qëndron në krah. Do të keni mundësinë të kaloni në veprim, duke realizuar edhe gjëra që i konsideroni shumë të vështira.

VIRGJERESHA

Sot këshillohet të përballemi çështje të pazgjidhura në fushën e dashurisë. Duhet t'i shqyrtoni gjërat nga çdo këndvështrim, pa u fshehur pas iluzioneve. Nëse një epur ju kërkoi të punoni përtej kompetencave tuaja, qëndroni të qetë dhe refuzoni.

PESHORJA

Pas ditësh të mbushura me angazhime, po vijmë momente më të qeta. Do të ndiheni në formë, të qetë dhe në dispozicion të personit që ju qëndron në krah. Do të keni mundësinë të kaloni në veprim, duke realizuar edhe gjëra që i konsideroni shumë të vështira.

AKREPI

Gjithçka do të shkojë për më mirë, mbi të gjitha nëse kërkoni të veproni në aktivitetin tuaj, gjithmonë duke u bazuar te kriteret e paanshmërisë dhe respektit për të tjerët. Ndërkaq, Hëna mund të tregohet dinake dhe sot do të keni si situata, pozitive ashtu edhe tensione.

SHIGJETARI

Sot do të ndiheni disi të bllokuar dhe do të lëvizni pak me vështirësi. Ndërkaq, nuk do t'ju mungojë rezistenca dhe pozitiviteti. Do të merrni në dorë një çështje, që ka ngjitur dhe do t'ju jepni zgjidhje me një ndërhyrje të zgjuar dhe të ekuilibruar.

BRICJAPI

Saturni krijon një premisë të shkëlqyer për anën profesionale. Intuitat e castit do të bashkohen me aftësinë për të konkretizuar projektet. Do të vëzhgoni me vëmendje sjelljen e një personi që kërkoi t'ju bëjë të besoni se është çfarë nuk është në të vërtetë.

UJORI

Me Neptunin dhe Marsin armiqësor nuk do të jeni në humor të mirë. Do të kundërshtoni çdo gjë që thoni. Mos e ekzagjeroni, ndërkaq! Do të jeni i tendosur dhe personi i zemrës do të vendosë t'ju shpërfillojë, duke ju lënë të vetëm të tejkaloni shqetësimin që keni.

PESHQIT

Sot do të keni surpriza të këndshme dhe do të jeni shumë aktivë. Me të vërtetë do t'ia kaloni bukur! Do të keni dëshirë t'i përkushtoheni studimit të lëndëve të reja, mbi të gjitha do të preferoni shkencën dhe matematikën.

PO LIND NJË VEPRIMTARI E RE



Sporti dhe konkretisht futbollit duket se po shërbejnë për të zhdukur një herë e përgjithmonë kufijtë gjeografikë edhe në vendet e Europës Juglindore, që ende nuk janë bërë pjesë e Europës së Bashkuar në aspektin politik. Së fundmi është hedhur ideja e "Mega Ligës". Një projekt i iniciuar në Rumani, që bën fjalë për pjesëmarrjen e disa skuadrave të përzgjedhura nga

"Mega Liga", ja projekti që pritet të startojë në 2019-ën

vende të ndryshme në Europën Juglindore, pa cenuar kampionatet respektive dhe që do të ketë të ardhura të konsiderueshme. Projekti "Mega Liga" përfshin vendet si Rumania, Greqia, Izraeli, Serbia, Bullgaria, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Sllovenia, Qipro, Maqedonia,

Azerbajxhani, Shqipëria, Gjeorgia, Armenia, Moldavia, Kosova dhe Mali i Zi. Në total, organizatorët kanë përllogaritur që të kenë 42 skuadra pjesëmarrëse, të cilat do të ndahen në dy kategori. 20 në të parën dhe 22 në të dytën. Në mediat rumune është njëri prej ide-

atorëve që e ka saktësuar edhe shifrën e madhe të të ardhurave që pritet të ketë një projekt i tillë. "Presim që të ketë të paktën 200 milionë euro të ardhura nga të drejtat televizive për këtë kompeticion. Urojmi dhe shpresojmë që të gjejmë gjuhën e përbashkët me federatat dhe skuadrat respektive, në mënyrë që kjo nisim të mos cenohet as kampionatet vendëse", ka deklaruar

ar Rumen Vatkov, për "Ziare.com". Ish-drejtori i marketingut në klubin e CSKA Sofjes është një prej ideatorëve që ka përpiluar edhe formulën financiare për funksionimin e kësaj lige. Në bazë të idesë fillestare, organizatorët presin që të përzgjedhin të paktën nga një ambasador në secilin prej këtyre vendeve, i cili do të jetë një njeri me influencë në botën sportive.

Ylli i Real Madridit akuzon për merkaton e dobët në verë, me largimet e Pepes, Hamesit e Moratas

Ronaldo kapet me gazetarët: Golat e mi i gjeni në "Google"

Portugezi, i shokuar pas humbjes me Totenhemin



Jeton Selimi

Kristiano Ronaldo, "ylli" portugez i Realit të Madridit, nuk i kurseu kritikën për politikën e drejtuesve në merkato. 32-vjeçari theksoi pas disfatës së radhës së "Los Blancos" me Totenhemin në "Uembli", se gjatë merkatos së verës nuk janë mbushur boshllëqet pas largimit të disa lojtarëve, siç është rasti i Hames Rodriguezit. Ai shtoi më tej se, "lojtarët e dëmtuar Dani Karvahal, Gareth Bejl mund të zvendësoheshin me eksperiencën e Pepes, Hamesit apo të Alvaro Moratas", që u lar-

guan respektivisht të Beshiktashi, Bajerni i Mynihut dhe Çelsi. Ronaldo në fakt është shumë larg shifrave të tij të zakonshme në këtë fillimsezon. Pas 10 javëve të para të La Ligas, ku është aktivizuar në vetëm 6 ndeshje për arsye pezullimi, ka shënuar vetëm një gol, pikërisht në fitoren 1-2 në fushën e Getafes. Sa i përket të ardhmes së tij në Madrid, ai u shpreh se kontrata aktuale i përfundon pas shumë vitesh, ndaj nuk ka ndërmend ta rinovojë. Ai dha një intervistë "flesh" pas ndeshjes me Totenhemin në Angli, ku Reali i Madridit u mund 3-1. Për "Bein Sports", ai tregoi versionin e tij për atë disfatë: "Është diçka e keqe, sepse në jemi mësuar të fitojmë. Po luajmë me një brez të ri. Duam të ndryshojmë dhe jam i sigurt se do




të ndryshojmë. Kemi ende shumë kohë për t'u përmirësuar dhe jam i bindur se do ta bëjmë. Nuk mund të jemi gjithnjë mirë. Nuk po luajmë

aq keq. Besoj se gjërat do të ndryshojnë", - tha Ronaldo për humbjen e fundit. Më tej, ai foli për rinovimin: "Jam mirë, por nuk i dihet. Nuk

dua të rinovoj me Realin e Madridit", - theksoi portugezi, duke i hapur rrugën kështu largimit nga madrilenët. Për dobësitë që po shfaq skuadra këtë sezon, Ronaldo u shpreh se largimet i kanë prishur shumë punë Realit: "Të gjithë lojtarët që u larguan këtë verë, na kanë prishur punë. Nuk është justifikim, por lojtarë si Pepe, Hames, Morata na kanë sjellë probleme. Këta djem të rinj që kemi në ekip janë e ardhmja, por ata janë të rinj dhe u duhet përvojë". I ngacmuar nga gazetarët për çështjen e golave, portugezi u përgjigj me nervozizëm: "Ju këni qëllime të këqija. Por statistikaty janë, futuri në 'Google' dhe kërkoni 'Golat e Kristiano Ronaldos', janë të gjitha aty", - tha portugezi dhe u largua menjëherë.

MIQËSORET E NËNTORIT



Sampaoli e lë sërish jashtë Gonzalo Higuainin

Trajneri i Argjentinës, Jorge Sampaoli ka publikuar listën me futbollistët që do të grumbullohen për dy takimet miqësore të nëntorit, ndaj Rusisë dhe Nigerisë. Në listë mungon sërish emri i bomberit të Juventusit, Gonzalo Higuain, edhe pse ky i fundit ka treguar një formë për t'u admiruar në takimet e fundit me bardhezinjtë, ndërsa mesfushori i Milanit, Lukas Biglia është lënë jashtë për shkak të dëmtimit. Rikthehet në grumbullin sulmuesi i Mançester Sitit, Sergio Aguero, ndërsa është konfirmuar edhe kapiteni i Interit, Mauro Ikardi. Argjentina do të përballlet me organizatorin e Botërorit, Rusinë më 11 nëntor dhe 3 ditë më pas me Nigerinë.

Në Londër nuk e kanë kapërdirë disfatën

Kritikat pas humbjes me Romën kanë bërë që në klubin e Çelsit të merrret në shqyrtim ideja e largimit të mundshëm të Antonio Kontes nga drejtimi i skuadrës që nuk po shfaqet bindëse as në kampionat dhe as në Europë. Por sipas "Mirror", një mbledhje e drejtuesve të klubit ka përfunduar me konfirmimin e trajnerit italian të paktën deri në fund të sezonit. Drejtuesit mendojnë se trajneri ka eksperiencën e duhur për të dalë nga kjo situatë ku gjendet skuadra, duke filluar nga fundjava ku përballë Çelsit do të jetë në fushën e lojës ekipi i Mançester Junajtidd. Një fitore në këtë duel do të kthente përsëri entuziaz-

Humbja me Romën, tani largimi i Kontes është më shumë se një ide



min në radhët e bluve londinezë. Nga ana tjetër, në klub janë të ndërgjegjshëm se nuk është faji i Kontes, që shumë lojtarë u dëmtuan në këtë fillimsezon, duke e detyruar trajnerin të improvizonte for-

macionin thuajse në çdo ndeshje. Kante, Moses, Drinkuoter dhe Morata kanë munguar me radhë, ndërsa Bakajoko dhe Rudiger kanë pasur vështirësi përshatjetje në Angli.

Ish-trajneri i Serbisë paralajmëron Taren

Pavarësisht kualifikimit për në Botëror, Slavoljub Muslin është tashmë ish-trajneri i Serbisë. Divergjencat me federatën kanë bërë që trajneri 64-vjeçar të largohet. Ka pasur polemika për përfshkrimin nga lista e kombëtares të Milinkoviç-Saviç, mesfushorit të Lacios, ndërkohë që thirrret Mijat Gaçinoviç i Frankfuritit, pavarësisht minutazhit të limituar. Këto zgjedhje kanë sjellë shumë dyshime. Ndërkohë, ish-trajneri Muslin tregon se menaxheri i "xhevahirit" të Lacios kërkoi ta shesë atë për para, kështu që Igli Tare duhet të ketë shumë kujdes. Menaxheri i lojtarit në fjalë është ish-sulmuesi i PSV, Çelsi dhe Atletiko Madrid, Mateja Kezhman.

Muslin: Agjenti po kërkon të shesë Milinkoviç-Saviç



"Gjithmonë ka dashur ta manipulojë shtypin. Shpesh ka folur me shumë ish-lojtarë për grumbullimin e Milinkoviç-Saviç. Ai ka vetëm një gjë në mendje: të bëjë para sa më shumë nga transferimi i

djaloshit. Lojtarët e inkuadrohen gradualisht në kombëtare", ka thënë Muslin. Ka reaguar edhe vetë Kezhman, duke thënë se trajneri serb nuk është shkarkuar për çështjen e Sergejit.

TRAJNERI I SKËNDERBEUT

Daja: Nuk mund të fitosh me kaq shumë polici

Në intervistën pas ndeshjes me Partizanin e Beogradit, trajneri Daja u shpreh se kundërshtari fitoi prej episodeve, dhe ndoshta skuadra e tij mund të merrte diçka më shumë. Gjithsesi, ai u shpreh se fakti se kishte kaq shumë polici, nuk e bën një ambient të qetë për një ndeshje futbolli. "Ishim sulmues, nuk reaguam pas pësimit të golit. Ishte një ndeshje që ishim të barabartë me kundërshtarin. Patëm rastet tona në goditjet standarde.



Nuk duhet që të bënim këtë lloj paraqitje për sa i përket episodeve, jo për sa i përket lojës në tërësi. Pjesë e lojës janë edhe gabimet. U ndeshkuam nga një gabim i yni dhe një goditje standarde. Meritonje Skënderbeu diçka më shumë? Ky është një konsta-

tim i drejtë. Kundërshtari nuk na kërcënoi aq shumë. Por, ishte një ndeshje e futur me episode. Deri në minutën e golit të parë, edhe Partizani nuk kishte raste të porta jonë. Besoj se ndoshta nuk mund të fitonim, por të paktën mund të merrnim një barazim. Ndeshja nuk pati asnjë problem, por kur sheh kaq shumë polici, ky nuk është ambient i pranueshëm për një ndeshje futbolli. Gjithsesi, nuk patëm probleme të tjera".

KAPITENI

Shehi: Kemi shanse nëse ndalim Dinamon e Kievit

Në intervistën pas ndeshjes, portieri Orges Shehi u shpreh i kënaqur me lojën e ekipit, por tha se kundërshtari fitoi, sepse ata nuk i shfrytëzuan rastet e veta. Gjithsesi, Shehi tha se ekipi ka ende shpresë për kualifikim, nëse do të marrë ndonjë pikë ndeshjen e radhës me Dinamon e Kievit. "Ishte një ndeshje e rëndësishme, përballë një kundërshtari të fortë. I tillë është futbolli, kur nuk shënon do ndëshko-



hesh. Gjithsesi, mendoj se bëmë një paraqitje të mirë. Shkuam te porta e kundërshtarit. Patëm rastet tona, por nuk i shfrytëzuam. Luajmë në një kompeticion shumë të fortë, me kundër-

shtarë tej mase të fortë. Kemi luajtur me të gjithë dhe jemi paraqitur dinjitozë me të gjithë. Nëse marrim ndonjë pikë me Dinamon, mund të jemi ende në garë".

"Grobari", thirrën: Kosova është Serbi Skënderbeu është i fundit në grupin B me 2 pikë

Skënderbeu nuk ia del në Beograd!

Partizani i Beogradit mposht korçarët 2-0

Jeton Selimi



Të gjithë dëshironin një tjetër rezultat. Skënderbeu në Beograd kishte pak nga çdo shqiptar me vete, por në fund korçarët u janë dorëzuar cilësive të ekipit serb dhe gabimeve foshnjake në mbrojtje, për të dalë kokulur nga ndeshja e jetës. Në "Humska" të Beogradit, gjysma e stadiumit është bosh për arsye sigurie, ndërsa drejtuesit e klubit serb kishin marrë masa për shtesë duke angazhuar shumë punonjës për sigurinë dhe forca rendi.

Takimi do të nisë i fortë, ndërsa në minutën e 5-të është Vangjeli që provon të befasojë Stojkoviçin, por gardiani serb është i vëmendshëm. Përgjigjet Tosiq në minutën e 14-të, por Shehi grushton mjaft mirë goditjen

e dënimit të mesfushorit. Në minutën e 26-të tifozët serbë lëshojnë thirrjet shoviniste "Kosova është Serbi", ndërsa gjyqtari nuk e ndërpret takimin. Partizani i Beogradit (minuta 34) nis ta mbyllë Skënderbeun në mesfushë dhe korçarët vuajnë presio-

nin, ndërsa në minutën e 39-të vendësit do të konkretizojnë epërsinë e tyre me golin e shënuar nga Zoran Tosiq, që ekezekuton saktë një goditje dënimi, duke e lënë Shehin të palëvizur nga vendi. Përpigjet të reagojë Skënderbeu 2 minuta nga

fundi i pjesës së parë, por Stojkoviç kontrollon gjuajtjen e Vangjelit. Në pjesën e dytë presioni i Partizanit bëhet edhe më asfiksues, ndërsa Skënderbeu nis të humbasë dhe topa elementarë në mbrojtje. Në minutën e 61-të Tavamba përpigjet të

befasojë Shehin me një parabolë të bukur, por veterani i portës reagon në mënyrë të shkëlqyer duke e kaluar topin mbi tra. Përpigjet në një farë mënyre Skënderbeu të reagojë, por gjuajtja (64) e Soues është mbi tra. Golin e dytë Partizani do ua dhurojnë vetë korçarët. Shehi dhe Lilaj gabojnë duke i dhënë mundësi Tavambas të rrëmbejë topin e të pasojë për Ozegoviç, që me portën bosh, shënon lehtësisht. Në të 74-ën Jashanica mund të kishte rihapur ndeshjen, por Stojkoviç grushton gjuajtjen e fundit në kuadrat të Skënderbeut, ndërsa Partizani i Beogradit i afrohet golit dhe në momente të tjera. Gjithsesi do të mbyllet 2-0, me serbët që gjejnë fitoren e parë në grup dhe ngjiten të dytë pas Dinamos së Kievit, ndërsa Skënderbeu mbyll grupin B me 2 pikë.

NOTAT E NDESHJES

Mediat italiane fundosin Shehin dhe mbrojtjen. Soue cilësohet "hije"

Portali italian "Tuttomercatoweb" ka përkrahur me nota shumë negative paraqitjen e Skënderbeut në ndeshjen e sotme. Në rubrikën "Top dhe Flop" për gjërat që spikatën në takimin kundër Partizanit të Beogradit, kishte lëvdeta vetëm për vendasit.

TOP
Toshiç - Që nga fillimi është një prej lojtarëve që i jep një plus skuadrës së tij. Provon që nga minuta e parë që të vërë në vështirësi skuadrën kundërshtare, pastaj gjen një goditje dënimi të shkëlqyer që shtang Shehin.

Kompaktësia serbe - Ka lejuar shumë pak Partizanin gjatë 90 minutave, falë një kompaktësie që nuk i ka lejuar Skënderbeut të gjente hapësira.

Tauamba - Ai është njeriu që mbyll përfundimisht ndeshjen, duke gjetur golin e rezultatit përfundimtar 2-0. Krijon edhe raste të tjera që nuk arrijn t'i shfrytëzojë, por është një gëmb në këmbë për mbrojtjen kundërshtare.

FLOP

Mbrojtja shqiptare - Shumë i shpërqendruar dhe i kontraktuar, Skënderbeu nuk arrin të ndërtojë lojë në mënyrë krijuese dhe për më tepër, mbrapa bën nga të gjitha gabimet, si në rastin e golit të dytë të kundërshtarit.

Soue - Një hije për skuadrën shqiptare. Lëviz në mënyrë të crregullit dhe pa krijuar ndonjë shqetësim për kundërshtarin.

Shehi - Gabimi i tij, që çon te goli i dytë i Partizanit, është i rëndë dhe vë mbrojtjen e tij në vështirësi të madhe. Edhe te goditja e dënimit të Toshiç, që i dha avantazhin serbëve, qëndron i pa lëvizur. Mund të bënte më shumë.

U VRA NË FUSHË-KOSOVË

Car Llazari dhe provokimi i tifozërisë serbe

Tifozët ultras të Partizanit të Beogradit, grupi "Grobari", kanë shpallur edhe koreografinë e përgatitur për ndeshjen me Skënderbeun. Siç edhe ishte mësuar, ata shpallorin një imazh të Car Llazarit, një nga serbët që identifikohet edhe si themeluesi i "Serbisë së Madhe". Në mesazhin poshtë portretit të Car Llazarit, shkruhet "Pagëzimi, mallkimi dhe betimi janë të shenjtë". Figura e Car Llazarit nuk është zgjedhur rastësisht, pasi ai është vrarë në betejën e zhvilluar me osmanët në Fushë-Kosovë.



TRAJNERI I PARTIZANIT TË BEOGRADIT

Khukiç: I kënaqur nëse Skënderbeu kthehet me mbresa pozitive në Shqipëri

Deklarata e trajnerit të Partizanit, Miroslav Khukiç, pas ndeshjes për "Supersport": "Dihej që ndeshjen mund ta vendoste një detaj i vogël, siç ishte goditja e Tosiq në pjesën e parë. Na u dha mundësia që të luanim disa më të tërhequr meqë krijuam avantazhin. Dihej që Skënderbeu ishte kundërshtar i vështirë dhe çdo ekip tjetër do ta ketë të vështirë përballë tyre. Gjithsesi, ne e morëm triplikëshin që dëshëm në ndeshjen direkte. Jam shumë i kënaqur edhe për tri pikëshin, por do të isha edhe më i kënaqur nëse



Skënderbeu do të kthehej në Shqipëri me mbresa të bukura nga kjo ndeshje. Ne i konsiderojmë miq shqiptarët dhe jo si armiq. Shënimi i golit

vendosi ndeshjen. E dinim që në fillim që do të ishte sfidë shumë e fortë dhe shumë e vështirë, por në fund ja dolëm".

"Saipov ka thënë se është 'i lumtur' pas krimit"

Sulmi terrorist në Nju Jork, Trump: Autori duhet të dënohet me vdekje



të marrë dënimin me vdekje", tha Trump në rrjetin social "Twitter". Të hënën, Saipov, me prejardhje nga Uzbekistani, ka goditur kal-

SHBA - Presidenti amerikan Donald Trump tha se emigranti uzbek i akuzuar për sulmin me kamion në Nju Jork pak ditë më parë, ku vdiqën 8 persona, duhet të dënohet me vdekje, por shtoi se ai nuk duhet dërguar në qendrën e Guantanamo në Kubë, ku mbahen të dyshuar për terrorizëm. Presidenti tha se do të donte së tepërmi që "Terroristi i Nju Jorkut të mbahej në Guantanamo,

DEKLARATA

Trump tha se pas sulmit, Saipov ka thënë se është "i lumtur" dhe ka shprehur besnikëri ndaj grupit militant Shteti Islamik. "Terroristi i Nju Jorkut ka qenë i lumtur. Ai ka vrarë tetë veta dhe ka plagosur rëndë 12".

por sipas statistikave, ky proces merr një kohë shumë më të gjatë" sesa shqyrtimi i çështjes së tij përmes sistemit amerikan të gjykatave. Trump tha se është më e përshtatshme që i pandehuri të mbahet në

qytetin e Nju Jorkut, ku ai kreu krimin e tmerrshëm, duke shtuar se procesi gjyqësor ndaj Sayfullo Saipovit duhet të zhvillohet me shpejtësi, drejt dënimin me vdekje. Presidenti i Shteteve të Bashkuara,

Donald Trump, reagimin e parë sa i përket aktit që kreu Sayfullo Saipov, i cili është akuzuar për vrasjen e tetë personave në Nju Jork, e pati ditën e mërkurë ku deklaroi se ai duhet të dënohet me vdekje. Trump tha se pas sulmit, Saipov ka thënë se është "i lumtur" dhe ka shprehur besnikëri ndaj grupit militant Shteti Islamik. "Terroristi i Nju Jorkut ka qenë i lumtur. Ai ka vrarë tetë veta dhe ka plagosur rëndë 12. Ai duhet

7 pjesëtarë dënohen me burg të përjetshëm, 4 shpallen të pafajshëm

Përplasja në lagjen e "Trimave" në Kumanovë, 746 vite burg shqiptarëve

37 personat e arrestuar akuzohen për terrorizëm



Gjykata jep dënimin me 25 vite burg në total

Trafik kokaine me vlerë 4 milionë paund, dënohen 4 shqiptarë në Angli

BRITANI: 4 shqiptarë, anëtarë të një bande të trafikimit të kokainës në Britani janë dënuar nga një gjykatë me 25 vite burg në total. Shqiptarët e dënuar janë Nuri Mucmataj, Bekim Halilaj, Fitim Halilaj dhe Tomas Hela, të cilët kanë trafikuar kokainë të klasit A me vlerë 4 milionë paund në Southampton. Ata u arrestuan në 21 prill të këtij viti pas një hetimi 9-mujor të policisë, e cila i mbante në vëzhgim. Arrestimi i tyre erdhi pasi policia kontrolloi një furgon në Southampton ku u gjet kokainë e pastër me vlerë 140 mijë sterlina. Më pas policia kreu kontroll të mëtejshme në Carrington House, në Westwood Road, Portswood, ku u arrestua Bekim Halilaj si dhe u gjet kokainë me vlerë 10,000 paund kokainë. Sipas mediave britanike shqiptarët shpesh përdornin edhe emra të rremë në mënyrë që të qëndronin në Angli. Po të njëjtat burime pohuan se: Nuri Mucmataj, 26 vjeç është dënuar me 8 vjet e 6 muaj burgim; Bekim Halilaj, 21 vjeç, është dënuar me 7 vjet burg; Fitim Halilaj, 27 vjeç, është dënuar me 4 vjet e 6 muaj burg dhe Tomas Hela, 24 vjeç është dënuar me 4 vjet e 6 muaj burg.

Egla Xhemali

MAQEDONI

Gjykata themelore e Shkupit ka marrë dje vendimin për 37 pjesëtarë të grupit të Kumanovës. Shqiptarët kanë marrë një dënim prej 746 vjet burg, akuzohen për terrorizëm në luftimet e 9 dhe 10 majit në vitin 2017. 7 prej pjesëtarëve janë dënuar me burgim të përjetshëm, bëhet fjalë për Andi Krasniqi, Dem Shehu, Fadil Fejzullahu, Nasuf Zeqiri, Valdet Zekaj, Bek Bajra dhe Fejzulla Rushitovski. 13 shqiptarë kanë marrë një dënim prej 40 vitesh burg, ndërsa 6 të tjerë janë dënuar me 20 vite burg, të tjerët më pak se 18 vite burg. Katër shqiptarë janë liruar si të pafajshëm. Shumica e të dënuarve janë nga Kosova, llogariten si organizatorë të ngjarjeve tragjike në lagjen e "Trimave" në Kumanovë.



Në luftimet dyditëshe janë vrarë 10 pjesëtarë të forcave policore dhe 8 pjesëtarë të grupit të armatosur. Grupi kishte deklaruar se vendosja e tij në Kumanovë ishte bërë për shkak të shkeljes së të drejtave të shqiptarëve në

Maqedoni. Pala mbrojtëse deklaroi se procesi ka qenë i montuar nga shërbime sekrete që kishin për qëllim shpërqendrimin e vëmendjes nga kriza politike në Maqedoni, e nxitur nga afëra e përgjimeve.

SHQIPTARËT E DËNUAR NGA GJYKATA

- Andi Krasniqi, burg i përjetshëm
- Dem Shehu, burg i përjetshëm
- Qenan Hiseini, 20 vjet
- Fadil Fejzullahu, burg i përjetshëm
- Irfan Lutfiu, 14 vjet
- Fadil Elshani, 20 vjet
- Esat Kafegjollli, 40 vjet
- Adrian Bujari, 40 vjet
- Shefqet Hallaqi, 40 vjet
- Lirim Demiri, 20 vjet
- Hajrush Abdjija, 20 vjet
- Betim Kabashi, 40 vjet
- Genti Sefaj, 40 vjet
- Lendrit Rustemaj, 20 vjet
- Enver Hoxha-Klajn, 40 vjet
- Rufki Dogani, 40 vjet
- Nasuf Zeqiri, burg i përjetshëm
- Mirsad Qerimi, 20 vjet
- Vladet Zekaj, burg i përjetshëm
- Bajram Elshani, 40 vjet
- Nexhmedin Lika, 40 vjet
- Lirim Krasniqi, 40 vjet
- Sevdail Miftari, 40 vjet
- Fatmir Recica, 40 vjet
- Bek Bajra, burg i përjetshëm


Prokuroria spanjolle, urdhërarrest ndërkombëtar për ish-liderin e Katalonjës

SPANJË - Prokuroria spanjolle ka lëshuar dje një urdhërarrest ndërkombëtar për ish-liderin e Katalonias, Carles Puigdemont. Ky i fundit akuzohet nga autoritetet spanjolle për rolin që ai luajti në referendumin për pavarësinë e Katalonjës. Avokati i Puigdemontit, Pol Bekert tha se, nëse Spanja kërkon ekstraditim të Puigdemont, i cili ndodhet në Belgjikë, vendimi do të merret nga gjykata belge dhe jo nga qeveria. Avokati, po ashtu, ka njoftuar se Puigdemont nuk do të kthehet në Spanjë gjatë javëve të ardhshme. Gjykata e Lartë Spanjolle ditën e mërkurë u ka bërë thirrje anëtarëve të qeverisë rajonale katalonase të paraqiten në Madrid, si pjesë e një hetimi mbi rebelimin për shpalljen e pavarësisë së provincës spanjolle. Sipas gjykatës spanjolle udhëheqësit e shkarkuar të qeverisë së Katalonjës, Carles Puigdemont dhe 13 anëtarë të tjerë, duhet të paraqiten në Madrid në seancën e së enjtes.

PROCESI

Grupi kishte deklaruar se vendosja e tij në Kumanovë ishte bërë për shkak të shkeljes së të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni. Pala mbrojtëse deklaroi se procesi ka qenë i montuar nga shërbime sekrete që kishin për qëllim shpërqendrimin e vëmendjes nga kriza politike në Maqedoni, e nxitur nga afëra e përgjimeve.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Miller e Verdi-t.
5. Më e mira është rekord.
9. Inicialet e Derain.
11. Kishte 100 Teba.
12. Eshhtë vija e portës
13. Në fund të rritjes.
14. Drejtori Lokale Përmet.
15. Inicialet e Seagal.
16. King Cole i muzikes.
17. Ishte shpendi simbol i Jezu Krishtit.
21. Artikull spanjoll.
23. Janë fjalëpakë.
25. Fillojnë titrat.
26. Eshhtë i mërzitshmi.
27. Ashtu si jeton heremit.
29. U kompozua nga Ravel.
30. Janë spanjollët dhe portugezët.
32. Një kitarë indiane.
33. Janë edhe ato të sigurimit.

VERTIKAL

1. U quajt qyteti atomik.
2. Qyteti i Abrahamit.
3. Italia në tabela.
4. Sapo fillojnë.
6. Janë në botë
7. Një tabu islamike
8. I famshmi Pacino.
10. Janë si falimentime
11. Ngjyhet një në tavolocë.
12. Timo i Mato Gradës.
14. Janë borxhlinj.
17. E përditshmja që ke në dorë.
18. Carson i fumet-it.
19. U shkrua nga Sartre.
20. Në fund të vitit.
22. Eshhtë lloj poezie.
24. Janë shtëpi... qeni.
25. Janë kapriçiot.
27. Verifikuar pjesërisht.
28. Kërcimi i Fred Astaire.
31. Eshhtë sekrete në derë.
34. Kodi i celularit.
36. Daja i Amerikës.
39. Kaluar në krye.
43. Fillojnë detyrën.

35. Eshhtë e harlisur në xhungël.
37. Mbyllin fushatat.
38. Kështu thirrej Eisenhower.
40. Ai dhe ajo.
41. Fillojnë vallen.
42. Inicialet e Delon.
44. Kalohet në gjumë.
45. Martini që që këngëtare
46. Një thirrje me emra.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Atkinson, alias Mister Bean.
5. Ishte dyqanxhi i dikurshëm.
10. Ferrara regjisor.
12. Kalohet në gjumë.
14. Të parat në sondazh.
15. Eshhtë nofka.
16. Një treshë në skenë.
19. Nuk i tregohen babait.
21. Gjysmë tatimi.
23. Berenger aktor.
24. Në mes të një forme.
25. Bëjnë stil të lirë
28. Fillojnë nazet
29. Kalimi në kufij.
30. Një tragjedi... e Dreiser.
33. Grier aktore.
34. Dashi kur mungon ai
36. Eshhtë zanore në filma
38. Kufizohet në kufij
39. Ente Civile Europiane.

VERTIKAL


1. Eshhtë edhe ajo emërore.
2. Eshhtë edhe ai mbretëror.
3. Të parat në Wellington
4. Një vegël
6. Eshhtë vendi aderues
7. Eshhtë emirat.
8. Mbyllin portat.
9. Pak latinisht.
11. Janë zjarrvënës.
13. Qyteti i perjestshëm.
17. Kufizojnë rastet.
18. Shkroi Kënetarja tulle.
20. Inicialet e Moravia-s.
22. Janë trille.
25. Qytet italian.
26. Jepen për hartim.
27. Fillojë takimet.
29. Kufizojnë kënde.
31. Janë vendet e para.
32. Një greminë.
35. Eshhtë llogarin që qërohet.
36. Ndiqen me ilaçe.
37. Massari aktore italiane.
38. Janë kapot.
40. Numri i oktetit.
41. Kush ka... fërgëllon.
44. Një i fundit mbi të gjithë.
45. Një pjesë e satelitëve.
47. Fillojnë tjetrën.
48. Derisa janë në fund.
49. Inicialet e Taylor aktore.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

Fjalëkryqi
filozofik
Argëtim



- Ndryshimi ndërmjet asaj që bëjmë dhe asaj që jemi në gjendje të bëjmë, do të mjaftonte për të zgjidhur shumicën e problemeve të botës. **(Gandi)**
- Vetëm ata që guxojnë të humbasin shumë, mund të arrijnë shumë. **(Robert F. Kenedi)**
- Bëni më të mirën që mundeni, me atë që keni , kudo që të jeni. **(Teodor Rusvelt)**

Thënie të mëncura

SUDOKU

6					5		8	7	
9	5	7					3		
				1	4			9	
	8	9		7	1	4			
	3		2		8			5	
		6	9	4			1	2	
	9		6	3					
		3					5	4	2
8	1		4						6

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

8	7	2	5	6	9	1	3	4
6	1	4	7	2	3	8	5	9
5	9	3	4	1	8	7	2	6
4	8	9	2	7	5	6	1	3
1	6	5	9	3	4	2	7	8
3	2	7	1	8	6	9	4	5
2	3	6	8	4	1	5	9	7
9	4	1	6	5	7	3	8	2
7	5	8	3	9	2	4	6	1

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

5	H	2	I	16	J	A		12	7		7	6	6	11
1	4	3	8				10	1	14		5		1	8
18	1	8		5	3	9	3	8	2	12	2			
2	8		5	6	4	6	9	1	9	2		8		
8		12	1	15	2	8	1	11	2	7	8	3		
6	1	11		12	9	1				8	9	11		
9	3	1	2	6		7	16	2		1	3			
3	7	4		1	8	6		8	2	14				
	13	2	7	7		15	6	3	11		4	6		
4	2	12	2		8		11		1	13	3	17		
1	4	3	7	8	3	20	2	7	6		8	1		
8	1			18	1	9	1	12	1		2	8		

K	A	F	E		T	A	L	E	N	T
A	D	A	M		P	A	F	T	E	R
T	E	T		H	E	P	A	T	I	T
E	T		H	E	R	E	T	I	K	E
G		K	O	M	I	T	E	T	E	T
O		E	K	I	P	E	T	T	F	
R	I	K	N	E	T	T	A	P	A	
I		O	G	C		S	T	I	L	
K	P		S	W	I	N	G		S	L
E	O		P	A	T	E	N	T	A	T
N	A		Y	E		U	R	A	T	
T	Y	M	I		P	I	R	A	T	I

- "Testi i vërtetë i karakterit nuk është se sa ne dimë dhe se si ta bëjmë, por se si ne sillmi kur nuk dimë se çfarë të bëjmë." **John Holt**
- Suksesit është më i rrezikshëm se dështimi; dallgët thërrmohen në brigjet e qeta të detit. **Graham Greene**
- Pjekuri do të thotë të dish të bësh gjëra, për të cilat nuk na kontrollon askush: të kesh lekë në xhep dhe të mos i shpenzosh ato, të të bien në qafë dhe të mos duash të hakmerresh. **(Anonim)**

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

